



KUVENDI KOMUNAL - DEÇAN

Municipal Assembly of Decan

TRANSKRIPTI

DECANI

Mbledhjen e Kuvendit të Komunës

(Legjislatura e VII , mbledhja e V) me dt.27.06.2025



DEÇAN

e Premte, 27 Qershor 2025

Hajdar Sutaj

Të nderuar kolegë po fillojmë me seancën. Fillimisht e përshëndes kryetarin e komunës, zotin Bashkim Ramosaj, të gjithë drejtorët e drejtorive prezent, gjithë ju kolegë e kolege, gjithë ju të pranishëm. Mirë se keni ardhur në mbledhjen e pestë të rregullt të Kuvendit të Komunës së Deçanit, për vitin 2025. Nga lista e të nënshkruarve, kemi 23 prezent, nga gjithsej 27, që nënkupton që kemi kuorum të mjaftueshëm me vazhdu me seancën e Kuvendit. Mlejoni që, fillimisht t'ju lusë për qetësi. E dyta, të ju prezantoj rendin e punës, edhe pse e keni marrë, por sa i përket transkriptit nga mbledhja e kaluar nuk e kemi spse nuk është përgaditë për sot.

Pika e parë, kemi shqyrtimin dhe miratimin e transkriptit nga mbledhja e kaluar.

Pika e dytë, shqyrtimi i draftit të parë të kornizës afatmesme buxhetore KAB për 2026-2028.

Pika tretë, shqyrtimi i raportit të auditorit të jashtëm për ndërmarrjen publike lokale Higjiena.

Pika katër, shqyrtimi i planit ndërkommunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave për pesë komunat e rajonit të Dukagjinit, Pejë, Klinë, Istog, Deçan dhe Junik për vitin 2025-2035.

Pika pesë, është shqyrtimi i kërkesës së kryetarit të komunës për ndarjen e një hapësire, për ndërtimin e objektit për nevojat e shoqatave të dalura nga lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dega në Deçan.

Pika gjashtë, shqyrtimi i draft rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në administratën komunale.

Pika shtatë është kërkesa nga banorët e fshatit Bella e Epërme, për përkrahjen financiare për hapjen e një rruge të re, në fshatin Belle e Epërme.

Me rekomandim të KPF-së si pikë e tetë, hin edhe votimi i mjeteve buxhetore për marrëveshjen në mes së komunës së Deçanit edhe KRU Drini i Bardhë për hapjen e kanaleve të ujëitjes, për fermerët e komunës së Deçanit.

Dhe pika nëntë, të ndryshme. E hapi diskutimin për rendin e ditës. Nëse ka dikush diqka me komentu.

Mon Selmanaj fillimisht, pastaj Orgesi, pastaj Albesa. Po Vatan Istrefaj.. Mon Selmanaj e ka fjalën.

Mon Selmanaj

Faleminderit kryeues, përshëndetje kryetar, kryesues i kuvendit, drejtorë dhe ju të gjithë të pranishëm. Unë vërejtjen e parë e kom rreth vonësës së materialeve të Kuvendit, të cilat na kanë ardhë të martën me datën 24, dhe sot është 27. Domethënë, ka shumë mbledhje që nuk po përfillet procedurat ligjore për materialet e Kuvendit. Gjithashtu kemi mungesë transkriptin, apo procesverbalin e mbledhjes së kaluar. Unë propozoj që kjo të hiqet nga rendi i ditës, dhe të na jepni një arseshmëri pse këto transkripte, e kemi edhe të kalumen mduket një që nuk është ardhë, pse nuk po vijnë edhe cila është arsya? Materialet veq edhe, edhe një elaborim të shkurtër. Neve qëto materiale kur po na vijnë qishtu po na pamundësojnë përgatitjen për mbledhje, këta, besoj që të gjithë kolegët kjo vërehet. Nuk po du me thonë që kjo është ni lojë e keqe që, që është ka na bohet neve, në mënyrë që ne, të dalim para opinionit keq dhe të papërgatitur për seanca. Në të kundërtën i bije që, që ky pushtet lokal nashti është shumë i lodhur dhe kur ka kesi mungesa edhe kesi qasje, atëherë duhet mu ndrru patjetër. Faleminderit!

Hajdar Sutaj

Orgesi, Orges Tafilaj e ka fjalën.

Orges Tafilaj

Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë! Realisht fjalën e mora pikërisht për temat që ngriti Moni. Pajtohem që dy transkriptet që nuk kanë, nuk na kanë ardhur, nuk duhet t'i shqyrtojmë se s'kemi material, edhe realisht kryesues nuk besoj që mjafton vetëm telefonatat e tua me kompaninë për shkak se tash u bo dukuri kjo punë, ndoshta duhet të shikohet edhe që të ndërprehet fare kontrata, nëse kështu vazhdojmë, për muaj të tanë besoj që përderisa paguhen prej taksave të qytetarëve është mirë të ndërpritet. E dyta lidhur me materialin, po pajtohem me Monin, janë ma shumë se pesëqind faqe material dhe kushdo që i ka lexu, besoj që i ka lexu vetem si roman, jo si përmbajtje, dhe kërkoj që herave tjera materiali të vijë në kohë ashtu siç thotë rregulloria. Faleminderit!

Hajdar Sutaj

Faleminderit Orges, Albesa.

Albesa Cacaj

Përschendetje për të gjithë! Të njëjtat rekomandime ose të njëjtat kërkesa i pata edhe unë, përveq që du me shtu faktin se mungesa e procesverbaleve që është herë pas here, pastaj kemi edhe shtyrjen ose mospërbushjen e kriterit ligjor të cilin e parasheh edhe ligji për vetëqeverisje lokale, statuti, rregullorja e punës që mu pajisë anëtarët e kuvendit 7 ditë para mbledhjes edhe tre ditë para KPF-së. Kjo tashmë është shendërru në një dukuri, domethënë nuk është që po ndodh për herë të parë ose të dytën, edhe kjo e nxjerr në pah papërgjegjshmërinë e juve karshi anëtarëve të kuvendit, po edhe karshi qytetarëve, sepse tek e fundit ne jemi këtu mi përfaqësu qytetarët edhe me i vënë në pah kërkesat, ankesat edhe gjitha punët që kanë të bëjnë me komunën. Kështu që me ni fjalë është papërgjegjshmëri që po vazhdon tash e një kohë të gjatë. Faleminderit!

Hajdar Sutaj

Vatan Istrefaj e ka fjalën.

Vatan Istrefaj

Faleminderit për fjalën kryesues, përschendetje për të gjithë. Po ashtu dua ta them edhe unë problematikën e njëjtë, pasi që Kryesues ne nganjëher po dalim jashta vendimeve që i kemi marrë vetë këtu në Asamblen Komunale, pasi që bashkërisht me ty kemi marrë vendim që të gjitha kërkesat që vijnë nga asambleistat dhe rendit te ditës të jetë i përpunuar deri me datën 15 të muajit përkatës që mbahet seanca. Kjo nuk po respektohet personalisht kërkesat që i kam sjellë i sjelli deri me datën 15 për këtë seance, por pse nuk po bëjnë këtë edhe drejtorët e ekzekutivit komunal. Kështu që me një fjalë kryesues, tani jem në përfundim të mandatit, nëse në fillim kemi pa ndonjëherë mirëkuptim, po tash se paku presim një përgjigje serioze nga ti, pse po vanohet materiali kështu, apo ka ndonjë tendencë? Faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë. Kisha lutur regjinë që ti kaloj fjalën sekretarisë me u përgjigj sa i përket materialit.

Dyke Llojluni

Përschendetje për të gjithë pra, edhe pse kryesuesi ma dha fjalën, po ju njoftoj se unë si të më vijnë materialet i përcjelli. Po, pershembull, nuk është se nuk vijnë të gjitha. Unë pres deri sa të vjen materiali i fundit, ku të bashkangjiten te gjitha materialet i përcjelli, kush është i pari, kush është i fundit që i bjen materialet, aty është diçka tjetër, po kur të vjen materiali i fundit i përcjelli.

Hajdar Sutaj

Kolegë, po fillojmë me seancën, me vazhdim të seancës. E para a po ulemi.

Kolegë mas pari ju kërkoj falje edhe m'vjen keq për problemet teknike, arsyeja pse ka ndodhur ky problem teknik, është se kjo sallë përdoret për shumë aktivitete. Edhe m'vjen keq, që i kanë lëviz këto tavolina, edhe kur i kanë lëviz këto tavolina, kanë mujt me i demtu naj kabëll ose diçka. Mos me leju mu majt naj aktivitet këtu, po i bjen që jemi kundër dikuj ose diçka, po megjithatë ish dashtë me pas kujdes edhe kushdo që i merr ne te ardhmen sallën, e merr veç me shfrytëzu qeshtu qysh është, jo me bo zhvendosje ose diçka. E para nashta nuk ke edhe e duhur që ta kaloj te sekretaria, po krejt kuvendet përgjigjet sekretaria për qashtjet te materialit te ketyre gjanave. Hini përcjellni krejt Kuvendet ku ka te bejë me procedurën administrative, sekretaria përgjigjet. Unë në momentin që e nënshkruaj materialin me datë caktume materiali duhet të më qene i gatshëm, sepse rregulloret e kuvendit, ne plan t'punës janë parapame pikat, ata duhet me ditë, drejtorat ne këtë rast. Edhe ata që i bijnë kur ta bijnë me shti ne rend te ditës duhet me pas edhe materialin, jo mu u vanu, po herave tjera aj qe se bjen materialin brenda afatit kohor shkruhet ni koment që ky material nuk është ardhe dhe kjo pikë largohet. Po, drejtori Izet Zenuni ka fjalën.

Izet Zenuni

Përschendetje kryetar, kryesues, asambleistë, drejtorë. Te materialet, te drejtori i një drejtorie që ka ni material caktum, e dërgon vetem një kopje, qoftë a është voluminoze, qoftë a është nje flete, e dërgon një kopje te Kuvendi i Komunës, ndërsa për me shumëzë edhe për me shprenda te Asambleistat nuk është detyrë e drejtorit të drejtorisë. Na vetëm një kopje e dorëzojmë te sekretaria apo te zyrra e kuvendit, ju jeni ata që duhet me shpërnda me shumëzë për me dergu te Asambleistat. Domethënë, nuk janë drejtorat fajtor në këtë rast osht dikush tjetër.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë, faleminderit shumë. Kështu po vazhdojmë, a ka dikush tjetër diçka në raport me rendin e ditës. E hekim transkriptën, sa i përket transkriptit ka kaluar kontrata është shpall fitues një operator, nuk e di kur e nënshkruan kontratën, janë procedurat te prokurimit, vijnë edhe ato dy tjerat domethënë që janë mbet, me propozimin që hekët prej rendit të ditës transkripti, a jeni për këto pikat tjera të rendit të ditës. Po urdhero Teutë.

Teuta Neziraj

Përveç vërejtjeve që u cekën nga parafolësit që nuk mendoj se duhet ti përsëriti unë propozoj që pika nr.4.Shqyrtimi i Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave (PNMIM) për pesë komunat e rajonit të Dukagjinit: Pejë, Klinë, Istog, Deçan dhe Junik 2025 – 2035 të hiqet nga rendi i ditës mos të shqyrtohet sot me arsyetimin se materiali është shumë voluminoz dhe ne nuk jemi të papërgatitur për këtë material.

Hajdar Sutaj

Nuk mendoj që ish dashtë me u shty kjo pikë, sepse ka me dal në debat publik. Drejtori Izet Zenuni ka fjalën.

Izet Zenuni

Me gjithë respektin, po në fakt është material voluminoz, edhe materialet nuk janë ardhë me kohë. Po katër komuna e kanë kalu në asamble komunale seancën e kalume ndërsa ne jemi në këtë muaj, do të thotë në muajin korrik duhet me dal si dokument përfundimtar në seancën që vjen. Gjatë këtij muaji duhet me ju nënshtrë debatit, diskutimit publik edhe gjatë muajit mundemi me dhënë edhe vërejtje dhe sygjerime, ndërsa mbledhjen e korrikut të asamblesë mundemi me kompletu si dokument për me dalë përfundimtar. Ju kisha lutë me kalu në lexim te parë, e atëherë me vazhdu me procedurat tjera.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë, e qes në votim rendin e ditës. Kush është për, a ka kundër, a ka abstenim. Konstatohet që kemi miratuar rendin e ditës, jemi te pika e parë shqyrtimi i draftit të parë të kornizës afatmesme buxhetore KAP 2026/2028. Kisha kalu fjalën te drejtoresha për buxhet dhe financa, Dafina Cacaj.

Dafina Cacaj

Faleminderit kryesues. Përshëndetje për gjithë, i nderuar kryetar, të nderuar asambleiste. Korniza afatmesme buxhetore është dokumenti bazë me të cilin edhe do të hartohet buxheti i komunës. Kjo kornizë afatmesme buxhetore, hartohet pas ardhjes së çarkores së parë buxhetore, e cila këtë vit është çarkorja 2026/1, ne bazë së cilës na kanë ardhur kufijtë buxhetor ne vija te trasha, edhe ne bazë të atyre ne kemi vazhduar me parashikimet te cilat mendojmë që duhen të jetë buxheti për vitin 2026 dhe parashikimet për vitin 2027 dhe vitin 2028. Fillimisht të sqarojë, që edhe e kam diskutu edhe më herët, e kemi sqaru që regjistrimi i popullsisë komunën e Deçanit ka me goditë me zvogelim të buxhetit dhe mundet me ndodh edhe me zvogelim të punëtorëve në tri sektoret, qysh është administrata, shëndetësia dhe arsimi. Për momentin nuk kemi një numër definitiv, në çarkoren e dytë vjen për vitin 2026 edhe numri i caktuar edhe i punëtorëve, se me këtë çarkore nuk është i përcaktum. Po për vitin 2027-2028, besoj që duhet bëhet diçka ose ndërrohet formula për shkak se buxheti veç po vjen tu ra edhe pjesa më e madhe e buxhetit po shkon për paga dhe medijtje. Granti i përgjithshëm për vitin 2026 do të jetë 6,723,133.00 euro, granti i arsimit 4,968,221.00, granti për shëndetësi, 1,692,341.00 dhe shërbimet rezidenciale 200,000.00. Granti i përgjithshëm pra do të jetë 13,583,695.00 ndërsa, përfshirë edhe te hyrat që është planifiku 968,279.00 atehere total buxheti do të del 14,551,974.00 që do të thotë diferencat për këtë vit është vetëm as 100,000.00 euro diferencë, për shkak të këtij zvogëlimit që ka ndodhur edhe Ministria ka marre përsipër mbulimin e minusit që do të krijohet për komunën e Deçanit dhe komunat tjera që kanë ramje të popullsisë. Për këtë arsye edhe buxheti mbetet gati si i njëjti me këtë vit, ndërsa për dy vitet e tjera, granti në total do të ketë zvogëlim për vitin 2017 do të jetë 13,367,806.00 euro, ndërsa për vitin 2028 do të jetë 12,478,732.00 euro. Në kategoritë te cilat kemi menu që duhet të bëhet ndarja për vitin 2027 paga dhe medijtje janë planifiku që do të shkojnë 8,921,380.00 euro, per dallim prej këtij viti që ka qenë 7,606,000.00 euro. Kategoria e mallerave dhe shërbime planifikojmë të zvogëlohet për 650,000.00 euro për shkak se pjesa më e madhe e buxhetit atëhere po shkon te pagat, do të jetë 2,000.000.00. Shpenziemt komunale kom kërku që të rriten për 50,000.00 për shkak të rritjes së çmimit të energjisë

elektrike, dhe subvencionet do të mbeten qysh edhe janë këtë vitë, edhe pse nevoja është që të rriten mirëpo buxhetin e kemi të ulët edhe mundësitë janë pak të kufizume. Ndërsa shpenzimet kapitale nga 3.5 janë afër 3 milion për shkak se pjesa më e madhe e buxhetit po shkon te pagat. Unë nuk kam diçka me diskutu ma shumë, kjo është në vija trasha buxheti që do të jetë për vitin 2026, nëse aprovohet nga Ministria e Financave edhe parashikimet për dy vitet e tjera. Nëse keni pyetje të tjera ose në lidhje me projektet kapitale jemi unë edhe kryetari të cilët mundemi me u përgjigjë për krejt pytyet që ju mundemi me i pasë. Faleminderit shumë!

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë drejtoreshë edhe përgëzime për punën. Arian Dobraj prej AAK-së ka fjalën.

Arjan Dobraj

Falemnderit kryesues, i nderuar kryetar, të nderuar kolegë dhe kolege asambleistë, po ashtu të nderuar drejtor në drejtoritë komunale. Faktikisht e tha edhe drejtoresha në vija te trasha, unë du me bo një përshkrim në emër të grupit në vija te trasha për shkak se është një dokument që don nje analizë pak ma të detajune prej secilit prej nesh faktikisht e diskutum pjesën e kohës nuk du me marrë pjesë te.. nuk du me zgjate tepër te ajo pjesë. Realisht, tek faqja e trete dikund e kemi disa rreshta ku e kanë gjithëpërfshirë te themi keshtu konkretisht planin që ka pasë edhe kryetari po edhe komuna e Deçanit, ose destinimin ose qëllimet tona që kemi pasë qysh para tre-katër viteve, që është një vazhdimësi realisht e punëve të mira dhe projekteve që po vijojnë me u kry në komunën tonë, të cilat normalisht që janë mëse të mirëpritura nga qytetarët e kësaj komune. Realisht turizmi dhe ekonomia kanë qenë disa fusha që janë zhvillu këto viteve të fundit shumë dhe që po pesojnë një rritje jashtëzakonisht mirë që është një pikë pozitive jashtëzakonisht e madhe dhe e mirë për komunën tonë, pasi dihet destinimi jonë që është kryesisht te pjesa e turizmit që po bon ni pjesë shumë të mirë edhe shumë të veçantë të komunës tonë. Lajmi i keq që e tha drejtoresha është rritja vetëm 100,000.00 euro për vitin pasus që, që vjen, apo? Kështu ishte edhe pastaj edhe mungesa e subvencionave apo rritja e pjesës ku përfshihen subvencionet, natyrisht që nuk janë edhe lajme të mirë këto, po ne e dijmë që kemi me pësu pak a shumë rënie për shkak të numërimit të popullsisë kohën e fundit, diçka nuk kam me shtu. Faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë. Prej LDK-së, Hyri Dobrunaj.

Hyri Dobrunaj

Përshëndete kryesues, kryetar, përshëndetje për të gjithë kolegët asambleist, drejtor të drejtorateve. Sa i përket kornizes afatmesme buxhetore e ceken të gjithë kolegtë, jemi të gjithë një mendje se materiali me të vërtetë ka ardh shumë vonë nje ditë para KPF-së edhe shumë pak kem pas kohë me e shiqu. Mirëpo në bazë të shpërndarjes buxhetore që ka ky, këto projeksione, LDK-ja nuk e mbështet sepse nuk mendon që është shpërndarje për zhvillim. Këto projekte janë të gjitha projekte që kanë fillu vite,vite gjatë dhe nuk kanë përfundu asnjëherë. Bile bile për disa duhet edhe me pytë, kemi nda e ku janë shku? Po na e dijmë se i ka marre përmbaruesi, edhe këto e dijmë që ka me i marrë një pjesë të madhe të këtyne përmbaruesi, e na s'kem me pas ne fundvitit as tre milion e diçka për investime kapitale. Me pyte kryetarin, përpos këtij objekti të, ndërtimi i bibliotekës dhe muzeut në fshatin Carrabreg te Epërm, a ka diçka të re prej projekteve kapitale, për këto tre vjet e ardhshme. S'ka asnjë projekt kapital, do të thotë ky buxhet nuk është buxhet i zhvillimit. Kaq!

Hajdar Sutaj

Prej vetevendosjes, Faton Selmanaj.

Faton Selmanaj

Faleminderit kryesues. Përshëndetje për të gjithë. Para se me fillu për temën, edhe unë pata vrejtje për materialet se nuk osht hera e parë por në vazhdimsi për gjatë gjithë mandatit thuajse që ka pasur vonesa të tilla. Po kësaj radhe materiali na ka ardhë ma pak se 24 orë para mbledhjes se KPF-se, gjë që nuk është aspak në rregull, sepse s'kem mujt mu përgaditë edhe mi shqyrtu sa duhet. Po du mu ndal te projeksionet. Pika dy është nderitmi i kanalizimit në fshatrat e komunës së Deçanit, në cilat fshatra? Për cilat fshatra bohet fjalë? Te pika gjashtëmbëdhjetë renovimi dhe rehabilitimi i rrugicave në Deçan. Për cilat rrugica? Osht projekt i ri po ashtu. Blerja e veturave zyrtare spo di nashti kishim mujt mi zavendesu me diçka tjetër, se po m'doket që keni vetura mjaftueshem. E ka projekte shumë ma të rëndësishme sa ndarja e 50 mijë eurove për blerje te veturave. Ndërtimi i kanalizimit në rrugën Elena Gjika, edhe per këtë naj informacion shtesë drejtoreshë kisha kërku. Elektrifikimi i Bjeshkes së Madhe bashkëfinancim me qytetarët projekt i ri, këtu pyetja osht se a kanë

përfundu, a ka përfundu, ndriçimi publik në secilin fshat dhe lagje të komunës. Ndërtimi i urës në Vranoc të Vogël dhe Urës në Rastavicë, rregullimi i shtratit të lumit Baballoq vazhdim, sish dashte mu cek vazhdim po si projekt i ri sepse s'ka fillu akoma asgjë ketu. Ndërtimi i ZIP Line produktet tjera edhe produktet tjera turistike, projekt i filluar, s'osht projekt i ri. Ndërtimi i objekteve të ri të komunës. Ku është planifiku mu ndertu ky objekt? Dhe pyetje tjetër shtesë është projektet me bashkëfinancim s'ka asgjë të planifikume, gjë që e kom ngrit edhe në Komitetin për Politikë e Financa. Për shembull, të përmirësimi të ujitjes, kanalizimit, energjia eficiente, projekte të ujësjellësit kane mujt secila prej tyre me ndodh, sepse në vitin 2022 qysh e kom cek edhe në Komisionin për Politikë e Financa, ka qenë një projekt për regjionin e Vokshit për ujë të pijës, të cilin e kemi inicu ne si grup, e i cili nuk ka marrë mbështetjen e komunës, domethënë është palnifiku ne buxhetin e shtetit prej Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapsinor Infrastruktues dhe të Ekonomisë. Jane nda mjetet ndërsa nuk ka marrë mbështetjen tuaj si komunë edhe si ekzekutiv. Faleminderit.

Hajdar Sutaj

Po kryetar, kryetari Bashkim Ramosaj ka fjalën.

Bashkim Ramosaj

E paska lexu komplet, bravo te lumtë. Kështu, po mundohna me thonë diçka e me u përgjigje ,me u përgjigje diçka për për do tema që i ngriti kolega i nderun. E për katër gjana jam i sigurt që vitin tjetër, kanë me, kanë me ndodhë në Deçan. Dhe janë për tri që nuk e kom naj qartësi tepër të madhe. Ajo që ka me ndodh është që e ka marrë driten e gjelbërt për shkak se u bo ni veprim para se me na ardhe neve korniza afatmesme, osht rruga e Elez Geci dhe Maxhun Berisha zgjerimi i kesaj dhe renovimi ose rregullimi i kanalit që shkon ne drejtim të Lumbardhit dhe Maznikut. Ajo që po ashtu jom i sigurt që ka me ndodh ka me ndodh rruga e fshatit **Pleqa**. Ajo që ka me ndodh është edhe Lumbardhi i Lloçanit që përafersisht është shetitorja e njëjtë sikur ne Lumbardhin e Deçanit, mirëpo që i ka disa ndërpreme sepse punimet e fillojnë në zonën ma të rrezikshme që osht Jasiqi, Baballoçi, Rastevica për shkak të regjionit që kane. Dhe ajo që ka me u ndodh me siguri është kanalizimi, ne i kemi dy projekte të hartume që janë projekte detaje, e ndoshta prej viti 2020 e deri sot ka mujt me ndryshu gjografia për shkak shpërndarjes të venbanimeve ose shpiave te ndërtume, po aty aty janë, edhe bohet fjalë për dy Srellcet, për Prapaqanin, Isniqin, Dubovikun, Lbushen edhe osht ni renovim ose përfundim i impiantit i cili osht ne Lumbardh që osht jashta krejtë standardeve te mundshme. Dhe poshtë është projekti i dytë, për te cilin nuk e kem naj qartësi, që fillon prej regjionit te Vokshit e përfundon dikun në mes **/hjk.;** Gramaçelit ku osht i projektum një impiant. Për tri gjana që thash nuk jam fort i sigurtë. Është qendra e qytetit të Deçanit për shkak të kostos dhe problemeve kontestive administrative që janë në të, dhe nuk e kem marrë naj dritë jeshile që kemi me u perkrahe për këtë temë, ose kemi me mujt me bo naj zgjidhje të shpejt. Kontestet për, qe besoj krejt qa jeni pjese e asamblesë e dini. Kemi ni paqartësi ende me rrugën e Plavës, për shkak se po pritët gjatë kësaj jave ose javën tjetër me u jep ni epilog prej një komisioni me tregu cillat punë kanë mbetur pa kry, dhe me u hap ni procedure tenderuese buxheti osht i sigurum për këtë pjesë. Dhe paqartësi po ashtu për neve është edhe pse jemi kon palë ose subjekti i diskutimit edhe miratimit te inkorporimit te interesave tona jo se e kem naj kompetencë mbi këtë çështje, është autoudha. Tash te kjo, pytet që ndoshta u bënë, se cilat janë rrugët në Deçan. Rruga e vjetër kur është konceptu me u bo me kocka, ka qenë njëfarë dizajnimi dhe njëfarë qëllimi që ndoshta me u shtru ne njëfarë lloj qarshie, ku ka me pas punime artizanale, ku ka me ruajtur strukturën e ni vendbanimi më të vjetër më asi, më tipik, mirëpo që nuk ka ndodhë. Dhe tash kjo rrugë është shtru ne problematik për shkak të automjeteve që kalojnë mbi te dhe keto kubeza po krijojnë njëfarë, njëfarë, jo udhetim te lezetshem dhe jo me standard në ate fare rruge. Dhe është vendosur që me u bo një projekcion prej Lapidari Deçanit, me u nderru keto kubeza deri te shkolla Lidhja e Prizrenit dhe degëzimit deri te, deri te vorret e Deçanit ose drejtimi përdaljes në Llukë dhe ne Beleg. Domethënë folet për këtë projekt të ri që ne e quajmë rruga e vjetër. Kisha pas, isha kon shumë i lumtur në rast se nuk diskutohen gjanat me tendencë në një segment. Ne kemi dërgu rrymë në tri drejtime, ama kemi dërgu krejt me forcat tonë buxhetore, si Komunë e Deçanit. E kemi qu rrymën në Bjeshkën e Madhe, projekt i përfundum. E kemi qu rrymën deri ne Baballoç te shoqata që është projekt edhe katër shtylla **megatr..** me vendos dhe përfundon si projekt. E kemi qu rrymën edhe në **Be...** në njërin segment. Tash ajo çka duhet mendohet është shpërndarja e tensionit të mesëm ose të ulët, si jemi mesu me i thënë na. Dhe ky nuk bohet ni, nuk bohet krahasim, a i kemi kry krejt fshatrat me elektrifikim, unë besoj që 95% janë te përfundum, kryen edhe 5% dhe jeta nuk bon me u nal, na duhet me pas ambicie pak, pak ma të medhaja, po besoj që jemi në rrugë të mirë deri në një marreveshje që ne na duhet me pasë me ZRRE-në, me KEDS-in me , dhe KEK-un, e cila është një problematikë që nuk ka zgjidhje të shpejtë. Do me thene projekti po kryhet, mirëpo puna administrative me këta për shkak të një konflikti që është procedural, sepse hidrocentralin e vjetër nuk e ka kurrkush në shfrytëzim dhe nuk e ka kurrkush ne pronësi. Është hapë si procedurës që tri herë dhe që tri herë

osht mbyllë pa ndonjë fitus. Kur po thojmë për fshatin Baballoç, edhe Jasiq I ri segmenti deri te Rastavica. Ne nuk mundem me e qitë si projekt te ri, sepse tjetërkush e ka buxhetin kryesor, dhe a kemi me financu na në fazën e parë, apo në fazën e dytë, mirëpo është ni projekt i cili tashmë ka mundësi me ndodh këtë vit, dhe ne duhet me parapa qe edhe vitin tjetër me, me përkrahë si, si buxhet komunal. Domethënë në këtë vit pritët që me u nënshkru dhe me u tenderu implementimi i këtyre punimeve, dhe dy sqarime, pse u met rruga Vranocit, rruga Vrancit, ura e Vranocit. Ni urë mbi të cilën zyrtarë të shtetit kanë bo filma, në atë pjesë për shkak të vërshimeve që kanë ndodh. Një rrugë që mundet në çfarëdo rasti me u shtru në tragjedi për shkak demolimit që e ka pas, avarisë që e ka pasur ajo. Edhe pse kemi insistuar shumë, edhe pse na u ka thonë shumë, ne është dashur me buxhetu vet. Dhe kjo procedurë është ndër procedurat e para të vitit buxhetor, tashtëm, që osht tenderu e ka fitu një kompani, është shku një kompani tjetër është anku dhe tash po e presim epilogun se cila prej tyne e ka e ka fitu si punë. Në këtë projekt nuk është vetëm ura e Vranocit, po osht edhe ura e Rastavicës, e cila e ka ni rrezikshmëri po aq sa ajo jo ndoshta te njejte, po perafersisht janë të njejta. Dhe po dalim te uji i pijës, a din kur thuhet diqka duhet me e thënë e vërteta e plote sepse më thonë pergjysmë edhe keqkuptohet. Ne rast se ju kujtohet koha kur ne kemi pasur problem me ujë të pijes. Ne ate kohe jane inicu dy projekte. Projekti i parë ka pas te beje me grumbullimin e ujit të pijes për dhjete fshatrat ashtu është quajt. Dhe ne ndërkohë neve na ka ardhë edhe ni propozim, një ofertë për me pas ni projekt te ri për Vokshin, ku ka pas shumë hipoteza, shumë supozime se ka ujë te mjaftueshëm në filan vendin e filan vendin. Dhe në këtë kohë, ne kemi angazhu njerëz të atij regjioni që me na i tregu ato burimet, kemi qu ekspertë të Hidrodrinit te cilet i kom ftu vetë, ka pas edhe inzhinjerë të Deçanit, ka pas edhe njerëz që janë brenda kësaj asambleje dhe kur buxheti vjen në afatin kohore dhe oferta vjen në afatin kohor kur përfundon cikli buxhetor brenda një vitit, e kjo është një hajgare e madhe, domethënë kjo është e vërteta totale per Vokshin si fshat dhe per -rns>/.. si fshat, ku ka pasur mundesi ni shumë e mjeteve prej 38,000 eurove per me hy ne funksion, per këtë, per këtë pjese e cila nuk ka hy se ka perfundu edhe viti buxhetor. Dhe nuk e di a mbetem borgj te bashkefinancimi. Bashkëfinancimi është një e drejte autonome e një grupi qytetareve e një komuniteti te caktum një fokus grupi, te cilet e jepin ni ide per bashkfinancim, dhe komuna duhet me pas një pjese te buxhetit ose duhet me e majt ndonje mbledhje ku ndan një buxhet sepse osht ardh dikush per me financu ni projekt qe ka mbledhur do pare komuniteti ose qe i kane donacion prej dikah. Dhe po ashtu jane organizata buxhetore nderkombetare, po sot jemi tu fol per kornizen afatmesme buxetore qe jane edhe besoj edhe kane me majt edhe 10 takimet derisa na vijne propozimet per buxhet. Osht mir qe po inkorporoni keto tema, esht mirë qe po pytni per këtë tema, por nuk osht, nuk esht momenti me i rendesishem i një skeme buxhetore ku na e projektojme, është ne fazen ne fazen ideore ku normal duhet me jep kontribut.

Hajdar Sutaj

Kryetar te falenderoj shumë. Me vjen keq që ka ndodhur nashta ni mos koordinimi i mirë me kryetarin sa i perket datës se caktimit të seancës edhe kryetari ka shumë angazhime sot planifikume. Po e ka, ish kryetarin e komunës Mehmet Bojkun, edhe e kisha lutë me u liru kryetar, dhe masandej , po po veç një minutë, jo se, ani në rregull është drejtoresha për buxhet dhe financa jemi edhe na tjerët. Kryetar shihemi për pak. Mon Selmanaj e ka fjalën.

Mon Selmanaj

Bile le ti dëgjon dy, një tri katër pyetje i pata kryetar rreth, rreth qetyne... nejse. Atëhere faleminderit kryesues. Drejtoreshë nëse ti munesh tash pak mu përgjigje ne këto pyetje, ta di për nderë. Me numrin rendor 15, ndërtimi i objektit te ri shtepia rezidenciale. Për tri vjet janë parapa diku 45.000 euro, po unë përveti nuk e di vendndodhjen se ku ndërtohet kjo dhe cili është qëllimi i saj, një. E dyta, i kemi me numrin rendor 23 dhe 25, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës për Bjeshkën e Madhe vazhdim dhe po për të njejtin vitë osht prapë vazhdim për të njëjtën rrugë. A është bo ndonjë gabim ne leshim ketu teknik apo, apo mund të na shpjegoje këta. Me numrin rendor 33 restaurimi i shtëpisë së kulturës dhe rregullimi i parkut në fshatin Lloqan projekti i ri. Unë nuk e di që në Lloqanë ka Shtëpitë te Kulturës, sepse kur ka ni epitët, ni emër, ni emërtim të tillë, atëherë duhet me pas aktivitete kulturore, argëtuese etj, etj. Aty, ajo është një odë sikur janë te gjitha pothuajse në gjitha fshatrat tjera, një odë që shërben për mbledhje, takime, aktivitete ndryshme të fshatrave dhe mu parapa ni shumë e tille, mendoj se nuk nuk perkon me nevojën qe ka komuna qe keto mjete te dedikohen dedikohen diku tjetër ku është shumë ma me rëndësi. Tjetër, numri rendor 40, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Mehmet Uka në Deçan. Kryetari pak a shumë e spjegoj, filloi ta spjegoj këtë, mirëpo aj është dëshmitar ai edhe shumica prej neve që kjo rrugë që tri herë osht ka ndertphet prishet ndertohet, dhe mendoj që këto mjete osht shumë ma mirë mu shfrytëzu ose mu dediku naj projekt tjetër, edhe ajo rrugë me mbet edhe pse tjetë edhe për katër pesë vite të ardhshme ashtu në atë gjendje është gjendja e mirë o stabile ajo rrugë nuk ka dert, me shku diku tjetër ku, ku, kish me, komuniteti kish me përfitu ma shumë, dhe numrin

rendor 41 ndërtimi dhe zgjerimi i rrugës Elez Geci Maxhun Berisha. Kryetari potencoi që ka me fillu kjo ka me u jetesu kjo rrugë, ju të gjithë e dini se kjo rrugë osht rrugë regionale dhe unë deshta me pyet kryetarin që a do të kompenzohen pronat se kjo kur bo zgjerimi i saj, ajo rrugë është shumë e ngushtë, kur bohet zgjerimi i saj, atëherë duhet të shpronsohen tokat e pronarëve të ndryshëm, aty, a ka, a janë siguru mjetet për këto apo, apo jo. Këto ishin një 4 apo 5 pyetje që unë ja pata dediku kryetarit, falemnderit, atëhere nëse mundes, uredhero.

Hajdar Sutaj

Mon falemnderit shumë. Drejtoreshë e ka pas një replike te drejte Fatoni. Le ta thotë pasandej.. Faton a ki me thonë diçka, edhe pastaj po e kalojm fjalën te drejtoresha, pastaj hapim edhe diskutimin nëse ka nevoj.

Faton Selmanaj

Faleminderit, kryesues. Po keq që shkoj kryetari, veç se, s'po them që s'ka projekte të rëndësishme, e që ish dashte me marrë përkrahje, absolutë ka projekte të rëndësishme, po nuk ka projekt më të rëndësishëm ma jetik se sa uji i pijes, për të cilat vuajnë te pakten dy regjione, të cilat janë shumë te banueshme, siç është Strellci edhe regjioni i Vokshit. Nuk po zgjatna më shumë pasi që kryetari nuk është këtu, nëse kthehet e na nxen, masandej e pata një replikë kështu direkt me të.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë. Drejtoresha për buxhet dhe financa, Dafina Cacaj e ka fjalën.

Dafina Cacaj

Faleminderit, kryesues. Po përgjigjja aq sa mundem edhe aq sa di.

Te shtëpia rezidenciale, e tha edhe kryetari që është veç faza e parë e planifikimit të buxhetit dhe janë veç një pikë trasha. Projekte që munen me ndryshu edhe përka buxheti edhe për rendesia deri në finalizimin e tabelave të fundit që kanë mu dorëzuar më 30 shtator në Ministrinë e Financave. Te shtëpia rezidenciale, na e kemi planifiku, ka qenë edhe vjet i planifikuar që të fillojë projekti i ri. Ne pjesën ku do të ndërtohet edhe procedurat tjera, ato gjithqyshe kanë me kalu nëpër asamble dhe ju njoftojmë me kohë. Bjeshka e Madhe vazhdim ka mujt me mbetur gabim teknik se ai vetem një projekt është edhe ndërtimi i shtëpisë së Kulturës në Lloqanë. Kjo pjesa e kodit të projektit për Lloqanë edhe për Carrabreg ka qenë vjet si iniciativë e USAID-it për një projekt i tyre që ka qenë për buxhetim transparent edhe me e votu vetë qytetarët, që projektet e tyre që ata i votojnë edhe i propozojnë me kalu në buxhet. Ka qenë si pilotprojekt, mirëpo për shkak të donacioneve që tash veç ju ka ndërpre, ju kane ndërprerë edhe aktivitetet e tyre edhe ket vit nuk e kemi vazhdu edhe na kemi detyru me majt në buxhet edhe këtë vit për shkak se ket vit unë nuk kom mujt me i nis procedurat edhe duhet të vazhdohet projekti për vitin 2026. Janë projekte që i kanë votu vetë dy lokalitetet, janë kon Carrabregi edhe Lloqani. Realisht ka fitu projekti i Carrabregit, se aty kanë pas fitu vetem një projekt, mirëpo kryetari ka vendosur që dyjat mi pasë në buxhet. Nuk kemi mujt këtë vit mi nis procedurat e tenderimit, do të fillojnë vitin tjetër besoj edhe shpresoj. A osht me rëndësi, a osht e pa rëndësishme, këtë nuk muna me vlerësu une përderisa ata e kanë vetë e kanë pru edhe e kanë vlerësu që është më i rëndësishëm projekt në lokalitetin e tyre. Te rruga Mehmet Ukaj, për njerezit që endën për ditë është shumë e vështirë me kalu edhe me vetura për me e pa sa është dëmtu, edhe nashta o kon e nevojshme ma kahere me u rregullu, po mundësitë buxhetore nuk kanë qenë. Edhe te rruga, Elez Geci Maxhun Berisha veq e diskutoj kryetari edhe ato procedurat a shpronsohen, a kompenzohen a keto, nuk besoj që na takojnë neve as mi disku, na vijnë në asamble nëse ka me kon procedur që duhet të shpronsohet është të kompenzohet dikush, ato shkojnë me buxhet projektit kur planifikohet, si shpronësimi, si projektimi si të gjitha edhe me këta hinë të gjitha. Projektet te cilat janë të parapame këtu janë projekte në vazhdim shumica, nuk kemi shumë projekte të reja për shkak se janë projekte që duhet të përfundohen, kanë fillu para dy-tre vjetëve edhe nuk mundem na me ndërpre buxhetin që me fillu një tjetër edhe mi lene ne gjysmë projekte të cilat veç janë në vazhdim edhe të pame për krejt. Faleminderit!

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë. E ka kërku fjalën Yllarta Thaqi. Po, po, pritni se vazhdimisht. Yllarta ka fjalën pastaj vazhdojnë të tjerë me radhë.

Yllarta Thaqi

Faleminderit shumë. Përshëndetje për gjithë. Konsideroj se në projektbuxhetin i cili tashmë e kemi përpara dhe po diskutojmë, uroj që të kryhen këto projekte, të cilat po vazhdojnë, po vazhdojnë, po vazhdojnë, brenda këtij viti, pak janë planifikuar projekte të reja, por megjithatë kaq është edhe korniza buxhetore e cila na dikton. Unë vazhdoj qëndroj se është dashtë të renovohet biblioteka e qytetit, të ndahet një kod, pavarësisht se ku e kemi zhvendosur bibliotekën e qytetit, *atje në podr* të qendra rinore edhe kjo bibliotekë e qytetit është dashtë të renovohet dhe të ndahet një kod, për arsye se ata që kanë mundësi me lexu të lexojnë poshtë, ata tjerë që dojnë rekreacion munden me shku me lexu edhe atje nalt. Njëkohësisht, të falënderoj për te pika 44 ndërtimi i shtëpisë së UÇK-së ku kam propozu te KPF-ja që të ndahet ni kod buxhetor për vitin 2026 nëse e votojmë na sot ndërtimin e një shtëpie derisa në vitin 2026 ka qenë me zero zero i planifikum. Keni planifiku 50 mijë euro deri në vitin 2028 ndoshta do të përfundohet duke shtu edhe çdo vit mjetet e tjera. Parimisht, mendoj se duhet ta përkrahim këtë buxhet. Faleminderit!

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë. Arian Dobraj e ka fjalën.

Arjan Dobraj

Faleminderit kryesues. Deshta deshta vetëm shkurt mu nderlidhe diçka, sepse na e dimë që pjesëmarrja në debate publike, qofsh për buxhetin, qoft për kornizën afatmesme që jemi tu diskutu, që jemi duke diskutu sot kryesues na e dijmë pjesëmarrjen e ulët ose shumë dobët *fra* qytetarëve. E kom pas një vërejtje qysh kom marre pjesë qysh para tre-karter viteve nëpër këto debate publike, kur keni thonë që nuk është, nuk është e udhës që me pru kërkesa ose qysh me thane, me kërku diçka asamblistat po du qytetarët në këto raste, kur mungojnë qytetarë, kush me kërku atëhere, se e patëm një temë që u ndërlidhem më herët drejtoreshë, deshta me të lute, që përnime nëse doni që edhe na asambleistat, po flas edhe për veti ne këtë rast me marrë pjesë, atëherë, naj merrni pak sado pak parasysht, ato që e kërkojmë për lokacionet për nga vijmë. A po din, se na nuk jemi kundër absolutisht prej fushëveprimit që është i paraparë, rezumuese që e paraqite pak më herët. Thjesht me na u marrë pak parasyshe që na me pas qka me tregu nëpër lokacionet ku vijmë. Falemnderit.

Hajdar Sutaj

Po, drejtoresha Dafine Cacaj ka fjalën

Dafina Cacaj

Po, është e vërtetë që kemi numër të ulët të qytetarëve që duhet marrin pjesë në debate, dëgjime buxhetore. Mirëpo, megjithatë këtë vit na kemi pas për një debat që veç e kemi majt, ka pas pjesëmarrje të mjaftueshme që kanë qenë përafër 43 qytetar që kanë marrë pjesë, nuk po thomë që është më e kënaqshme e mundshme, mirëpo ne krahasim me vite tjera është më e mirë edhe asambleistat nuk është e ndalume me marrë pjesë në dëgjime buxhetore, as nuk është e ndalume me sjellë propozime se kanë sjellë edhe më herët edhe kem pasur në buxhet. Ndoshta është me propozu edhe mja u marrë drejtën ose me hup kohën për mes me, me propozu qytetarët, po jo ju me kon bashkëhartues tanti me këtë buxhet edhe pse **[nuk kuptohet]**, jemi shpia jone, ki mujt me ardh edhe i kishim shkru nëse unë e kom harru ni projekt me rëndësi të veçantë për lokalitetin tone për me e shkru nuk është naj problem hiq, se nuk po di nashta edhe unë kom mujt me i harru prej vitit kalum ose prej tashit.

Hajdar Sutaj

Jo, dëgjoni kështu Arian. E patët drejtën e fjalës, e konsumove drejtën e fjalës, tu përgjigj drejtoresha, ki mundësi me i dërgu edhe propozimet edhe ti edhe gjith kolegët, të falenderoj shumë. Orgesi është, për me ditë rendin, Orgesi, Miftari, Albasa, Vatani, Sylja.

Orges Tafilaj

Falemnderit kryesues. Përshëndetje për të gjithë edhe njëherë. Fillimisht, kishe me qenë mirë ndoshta është gabim i vogël teknik, po të numerizohen faqet në mënyrë që të referohemi ma lehtë, përderisa e kemi përmbajtjen te numerizume. Te tabela 1, mbi tabelën 1 thotë, komuna e Deçanit në periudhën afatmesme buxhetore 2024-2026 nuk planifikon të merr hua nga institucionet financiare për te financuar projektet e saja. Nëse, ose duhet të jetë 2026-2028 ose nëse është kështu, atëherë a planifikohet për vitet 2026-2028 që nuk kish pas gjë te keqe financimi i projekteve të caktume. Tek projektet që janë parapare fillimisht me gëzoj fakti që ka hi kanalizimi i rrugës Elena Gjika, sepse me këshillën e banorëve të asaj lagjeje e kemi thane shumë herë në fillim të mandatit që është më se e nevojshme, njejen kohë, te zgjerimi i rrugës Elez Geci – Maxhun Berisha realisht është gezon fakti për ndertim dhe zgjerim, por shkak se ajo rrugë është shumë e rrezikshme për

momentin dhe besoj edhe Yllarta e ka ngrit shumë herë si çështje. Te tabela 10, ku është bërë analiza gjinore, mungojnë informacionet, ndoshta duhet te plotësohet. Njëkohësisht, unë jam pro që subvencionet të ndahen jashta këtyre tri drejtorive. Ndoshta kishte qene mirë një pjesë e tyre të kalojë edhe te drejtoria e bujqesisë. Te pika 4.4 tabela thotë numri i banorëve të komunës që marrin shërbime nga zyrat e gjendjes civile, zyra e gjendjes civile prap me slash. Unë nuk besoj që ka mu rritë numri për shkak se po besoj që çdo ditë e më tepër po digjitalizohet kjo pjesë, sidomos përmes e-Kosovës dhe nuk besoj që planifikimi duhet të jetë në renje, jo në rritje. Pjesa që do ketë 24 ore ujë, uroje të ndodh por nuk po shihet. Dhe krejt në fund besoj që edhe pse jemi pajtu komplet si asamble dhe kemi votu për, besoj që është dashur te hyjne edhe këndet e lojërave nëpër fshatra, nëpër ato fshatrat që nuk janë. Për shkak se e kemi votu, e kemi votu bashkërisht dhe është mirë që te ndodh. Falemnderit.

Hajdar Sutaj

E ka fjalën Miftar Ahmetxhekaj

Miftar Ahmetxhekaj

Kryesues faleminderit shumë, nëse ka mundësi une paraprakisht e kam një kërkesë, meqënëse dokumentin autori kryesor i cili e ka hartuar është kryetari i komunës, nëse ai eventualisht këtë agjend të takimit e ka te shkurt une kisha kërku një pauzë, jo pse unë nuk besoj në përgjigjen e drejtores ose drejtorit megjithate kam respekt, po për shkak se autor kryesor dhe përgjegjës është ZKA. ZKA është kryetari i komunës Deçanit. Nëse eventualisht nuk ka, unë mundem me ju. A mundeni me na konfirmu që kjo agjenda e tij kthehet apo nuk kthehet?

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë. A ki diçka tjetër?

Miftar Ahmetxhekaj

Apsolut qe po.

Hajdar Sutaj

Ok, mundesh me vazhdu se nuk e dijm na edhe sa kthehet, a qysh kthehet, jo jo mos e ki merak, nuk e dijm ne ashtu, mundesh me vazhdu ne ki diçka.

Miftar Ahmetxhekaj

E para. Dokumenti është projektion nuk është buxhet për vitin e ardhshem po projektion i cili pjesa dermuese ose në 90% mund të kthehet në buxhet. I vetëdijshëm se mandatar për me bo këtë punë është kryetari i komunës sbashku me drejtorat edhe e kemi thënë edhe ne seancat e kaluara është prej dokumenteve më të rëndësishme që e harton një komune. Që në hyrje të dokumentit vërehet një thellim ose një dallim shumë i madh mes dy kategorive. Paga dhe meditim dhe investimeve kapitale. Paga meditim arsytohet me Ligjin e pagave, që unë personalisht nuk e besoj shumë për shkak se ligji i pagave është prej 2023, ish dashte të reflektohet edhe në 2024. Shqetesuese, shqetesuese vazhdon të jenë investimet kapitale që janë në raport me 2025-2026 ju e keni theksuar që dallimi do të jetë 5%, ndërsa nëse ne i kalkulojmë shifrat, aq sa unë kuptoj ne matematikë, dallimi është shumë me i madh, është diku 600,000.00 euro te investimet kapitale në raport 2026 me 2025 që i bjen perqindja është me madhe. Projektet të projektuara projektionet për vlerësimin tem pjesa dermuese janë projekte te përsëritura, që i bjen edhe vitet paraprake unë e shikova dhe kornizen 2024 – 2026, prafërsisht, prafërsisht janë projekte të njëjta. Megjithatë duhet t'i potencoj disa prej tyre. Për vlerësimin tem që ndoshta ish dashte te rishikohen. Vazhdimi i projektionit për ndërtimin e rrethojave në qendrën rinore. Pse duhet, pse duhet ky projekt. Vazhdimi i projektionit për ujësjellës në Bjeshkën e Madhe, kur ne jemi dishmitar që pjesa dermuese e fshatrave të komunës së Deçanit përballen me mungese te ujit te pijes. Vazhdimi i asfaltimit ose projektionit për asfaltimin për Bjeshkën e Madhe, pse duhet të ketë rëndësi Bjeshka e Madhe në raport po supozoj me bjeshkën e Prilepit, Bjeshkën e Belegut apo Bjeshkën Roshkodolit? Vazhdimi që unë e kam gjykuar vazhdimisht, vazhdimi i investimit në shtëpinë alpine bjeshkatore. Kur pritet të ndërprehet ose është kërkesa e jemja, po, të bëhet një prerje, te sillet një raport sa është investu edhe ashtu ka ni verdikt, spo du me, as me fushatë elektorale, por ka ni verdikt që atje është investim i jashtligjshëm. Ndërtimi i kanalizimit për fshatrat e komunës së Deçanit, shuma planifikume pesëqin e pesëdhjetë mijë euro. As ju se besoni këtë projekt se është shumë joserioze. U fol për shtëpinë rezidenciale. Ndërtimi dhe zgjerimi i qendrës së qytetit dyqin e pesëdhjete mijë euro. Të njejtin kohe propozoni ndërtimi i komunës së re, i objektit të komunës së re.

Unë, në të gjithë jemi dishmitar, kemi pa ni projekt. Nëse eventualisht realizohet projekti i ndërtimit të komunës së re, automatikisht e ndryshon qasjen në qendër të qytetit, domethënë është ni projekt tjetër. Cili është me përparësi ose cili ka me ataku njoni tjetrin. Ndërtimi vazhdoni me e projektue ndërtimin e stacionit të autobusave në Deçan, kur ka me u bo qeky. Restaurimi dhe renovimi i monumenteve kulturorë. Komuna Deçanit në asnjë rast nuk di që ka investu në monumente kulturorë. Ndërsa për vlerësimin tonë, projektet të cilat ish dashte edhe pse po tham me përgjegjësi të plote, shpesh ne edhe vendimet të cila i marrin asambleja komunale i shkelim, para disa seancave ne kemi aprovue, kemi nda parcela kadastrale për tri qerdhe në fshatin Gramaqel, Strellc dhe Isniq, të cilat nuk janë të projektuara tash në këtë projektbuxhet. Qka ish dashte të jetë projekt mbi projektet? Prioritet është kanalizimi, vërtetë me mendu për kanalizimin për komunën e Deçanit? Është jetike kryesues, ndoshta pak po me kqyr me pak keshtu por seriozisht është jetike është jetike për qytetarët e Deçanit. U fol, nuk jam kundër shtëpive të kulturës nëpër vende tjere. Ish dashte të hartohet një projekt dhe.. Speaker...jo ja vazhdoni fjalën.

Meqenëse u fol të shtëpiat e kulturës, drejtor nuk e di a ka pasë ni raport ditët e fundit ka pasë ni avarie që është vërtetë shtëpi e kulturës së fshatit Isniq [nuk kuptohet], që ish dashte të jete projeksionin e juaj. Normalisht ndërtimi i kanaleve të ujitjes, ndriçimet publike, domethënë gjitha këto, gjitha këto për vlerësimin tem, drejtori ish dashte të jenë në projeksionin për vitin, që po flasim 2026-2028. Faleminderit shumë.

Hajdar Sutaj

Faleminderit Mirtar. Po patjetër, a din çka, me të vërtetë ke pasë propozime të shkëlqyeshme, edhe sinqerisht të përgëzoj. Qeto qka i the ti, kurr Deçani mu kurfar nevojë ska. Me pasë njëqind milion euro me i kry tana edhe... po, po, dy miliona e diçka janë për krejt investimet. Drejtoresha ka fjalën. Po ani tash.. io, po qeshtja e kanalizimit është projekt i madh, e jon edhe do projekte, që e din edhe Miftari.

Dafina Cacaj

Po edhe unë për hir të respektit që kam edhe kam shumë respekt për ju personalisht, e mora mundin me u përgjigjë, përshkak se na, nëse nuk është kryetari automatikisht atëhere na takon nashta neve me u përgjigj se spo di, na ndonjëherë po menojmë se jemi shumë të panevojshëm, ndonjëherë po menojmë që duhet me kon gjythysh këtu.

Hajdar Sutaj

Jo drejtoreshë je kompetente për atë punë.

Dafina Cacaj

Mirëpo, faleminderit, për krejt sugjerimet që i dhe, ose për prioritetet e projekteve, mirëpo, përderisa na jemi në pushtet, na i vlerësojmë cilat janë ma me prioritet se tjerat. Kur te vini ju atëhere i vlerësoni ato te juvet edhe i qitni në asamble e i votojmë.

Hajdar Sutaj

Mifatarit ju permend apo sju permend emri i jepi fjalën, urdhëro Miftar.

Miftar Ahmetxhekaj

Atëhere drejtoreshë, kështu unë me ni fjali po e përmbylli, nuk ka argument më të fuqishëm se sa për qytetarët e Deçanit të mendojnë mirë me 12 tetorë që dojnë me bo.

Hajdar Sutaj

Goja të lumtë Miftar, kurrë më mirë ske folë, bravo. Albesa Cacaj e ka fjalën?

Albesa Cacaj

Atëherë, përshëndetje edhe njëherë. Të nderuar asambleistë, të nderuar qytetarë. Du me nis diskutimin tem me ni fjali shumë të thjeshtë që ka të bëjë me mungesën e pjesëmarrjes së qytetarëve në debate publike. Kjo është tash e sa vite që jom përfaqësuese e qytetarëve të cilët me votojnë. Dymbëdhjetë vite që ka mungesë, mungesë të pjesëmarrjes së qytetarëve, sidomos në vitet e fundit, dhe arsyetimi i qytetarëve kur ne i thasim të marrin pjesë është që jo, nuk marrin pjesë, sepse, kërkesat tona asnjëherë me vite tana zvarriten dhe nuk inkorporohen në projeksionet ose në buxhetin e vitit të ardhshëm. Pse jom kundër këtij, këtij projeksioni, është sepse asnjëherë kryetari nuk e ka marrë mundin që projektet të cilat janë në vazhdimësi nga viti 2018-2020, nuk e ka marrë munin, përkundër kërkesave tona të vazhdueshme që të përgjigjet cilat janë projektet të cilat janë realizuar brenda një viti, brenda dy viti edhe që projektet që janë në vazhdim që pesë, gjashtë, shtate

vite, si përshembull projekti i kanalizimit, i ujësjellësit, i ndriçimit eficient e tjerë. Këtu nuk pava në këto projeksione, edhe pse është nevojë primare, nëse mundem me thonë, jo që jemi kundër zhvillimit të bjeshkeve, jemi për zhvillim të bjeshkeve, po jemi me i pas gjërat elementare niherë në rrafsh. Për shembull, nuk kemi fusha sportive, nuk kemi kanalizim, nuk kemi ujësjellës, nuk kemi parqe, nuk kemi trotuare te mjaftueshme, nuk kemi shtigje për biçikleta edhe pse është rregullorja për shërbimet publike, nuk kemi fusha sportive, nuk kemi objekte ku takohen të moshuarit dhe socializohen. Nuk kemi stacion të autobusave që 12 vjet është kërkesë e vazhdueshme. Nuk kemi kënd të lojërave ku dalin fëmijët tanë, e neve qytetarëve që jetojmë edhe përballëmi çdo ditë këtu me këto mungesa. Domethënë janë gjana të vogla, po që neve na bëjnë jetën e mundimshme. Faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë. Albese, ju që u shkrunë po u incizun, edhe po besoj që kjo pjesë ishte për me, për elektoratin. Urdhëro Vatan, Vatan Istrefaj e ka fjalën.

Vatan Istrefaj

Faleminderit për fjalën, kryesues. Së pari po filloj, drejtoresha pati një debat ma herët me një kolegë të aleancës, i tha na jem shpija e janë, hajde i bojnë projektet, a pe din. E na që sjemi shpia e juve tash, e jemi shpia tjetër, qe me bo na, qysh me i pru projektet. Faleminderit kryesues, po ja filloi tash fjalimit tim. Sa i përket kornizës afatmesme buxhetore, një projekt mjaft me rëndësi, një pikë mjaft e rëndësishme, te cilën kryetari është dashur padyshim që ta gjej kohën edhe të jetë këtu. Pavarësisht se ka takime, ndoshta të rëndësishme, por kjo ka një rëndësi të veçantë, pasi që sot është sjellur një dokument mjaft i rëndësishëm financiar, i cili nuk është publikuar në asnjë platformë zyrtare, pasi që këtë e thotë edhe udhëzimi administrativ për administratë të hapur, para se të vijë për votim të publikohet në ndonjë platformë zyrtare apo edhe neve uebfaqen e Fejsbukut. Kjo nuk është bërë, pra është një shkelje. Po ashtu, drejtoreshë personalisht nuk kam qenë në degjimet publike. Nuk është ardhur ndonjë raport prej degjimeve publike, pasi që e keni obligim me sjelle me qarkoren afatmesme buxhetore sot këtu. Tjetra që po du me thënë është se në këtë vend nuk ka projekte pra që perfshin edhe planin zhvillimor komunal që na e kemi miratuar muaj më parë. Pra, gjithçka që duhet bazohen këto projekte duhet me qenë pjesë e planit zhvillimor komunal që na e kemi miratuar në këtë seance komunale këtu. Po ashtu, shoh që ka një mungesë të madhe, pra nuk kemi thujse asnjë projekt të ri për, për zhvillimin e komunës sonë, as në infrastrukturë, as në zhvillimin rural, po ashtu as në ekonomi lokale apo turizëm. E kjo mungesë totale e vizionit kryesues po na çon në shpopullim e komunës sonë, pasi që në vitin 2011 kemi qenë katëdhjetë mijë banorë, kurse sot në vitin 2025 jemi vetëm 27 mijë banorë, apo 30% më pak. E si pasojë e kësaj, ka rënë numri i këshilltarëve komunal, pasi që në legjislaturën e ardhme do të jenë vetëm njëzet e një këshilltar komunal. Ka ndryshuar kategoria komunës në renditje, po ashtu vetëm nga granti i përgjithshëm mungojnë tetëqind e katër mijë euro për vitin e ardhshëm 2026. Po ashtu, drejtoreshë sa i përket projekteve u mundova që të lypj ndonjë projekt të ri cili ka bëje me shëndetin primar në komunën tone, nuk është asnjë projekt i ri. Po ashtu ne po i afrohem verës dhe është problematikë që ne e cekim kohë pas kohe prioritet kryesor duhet të jetë uji i pijës, pasi që pa ujë ska jetë. Kështu që çdo fshat pothuajse në komunën e Deçanit nuk ka ujë të rregullt, nuk ka furnizim me ujë të rregullt tani në kohën e verës. Na kallxo cfarë hapa keni bërë ju në këtë sferë? Faleminderit shumë.

Hajdar Sutaj

Drejtoresha a do me folë. Drejtoresha pastaj Sylja e ka fjalën. Jo, e kom tregu rendin, e ka pasandej Florimi pas Sylës.

Dafina Cacaj

Po. Na kur e patëm fjalën që projektet i bojm bashkë, e kom pas fjalën për komplet asamblenë se ka projekte që janë propozuar dhe prej opozitës që kanë pa, janë hy në projektligj buxhetit viteve te kalume që u kanë trotuari për, edhe Yllarta kur ka propozu si për lapidarët, si për trotuaret edhe projekte tjera. Prej qetu janë dale, nuk janë dal prej, prej komunave tjera. Edhe nëse nuk o publiku korniza afatmesme buxhetore, atëherë ka ndodhë ni gabim nga ana ime që ju kërkoj falje. Edhe pse unë po besoj që me material veq është i publikum po nuk e kom përcjellë edhe nuk e dije, nuk muj me thon kurgjo ma shumë.

Hajdar Sutaj

Drejtoresh, faleminderit shumë. Është e mirëkuptueshme që na jemi institucion edhe kur jemi institucion kemi drejte shpesh herë kështu me ju drejtu që jemi edhe si nje familje edhe e kuptojmë që në këtë kontest e ke thënë. Urdhëro Sylë. Sylë Balaj e ka fjalën.

Sylë Balaj

Atëhere, përshëndetje për të gjithë, pasi që shumicën e cekën edhe kolegët, po bëjë më shkurt. Te korniza afatmesme buxhetore 2026-2028. Cilat, cilat janë projektet e reja për fshatin Isniq. Po, unë me sa kam vërejtur nuk është asnjë projekt i ri, ku dihet që Isniqi është një prej taksapaguesve më të mëdhenj të komunës sonë. Faleminderit.

Hajdar Sutaj

Drejtoresha e ka fjalën.

Dafina Cacaj

Unë realisht, kërkesë nuk kam pas specifike për një projekt të caktuar që mundem me e pasë në buxhet, kanë qenë projekte që janë kon në vazhdim edhe që janë duke u përfunduar. Nëse është fjala për asfalt, është kontrata ekzistuese të cilat janë tenderume edhe që kanë mu përfunduar, që nuk, nuk janë ardhë hala në Isniq, ose ndriçimi publik, janë pjesë, janë kontrata që janë në vazhdim që janë të parapara me kalu edhe në, edhe mu kry në fshatrat të cilat nuk janë kryer deri tash. Mirëpo projekt konkret që nuk ka të bëjë me qeto qka janë të tenderume edhe janë në vazhdim, unë nuk kam pas me thënë drejtën, nëse keni ndonjë propozim, mundemi me pru deri në qarkoren e dytë kur ti majmë edhe debate tjera buxhetore edhe mi përfshi. Ama ato i that qka i kemi jo qka si kemi, veq i prioritizut. Edhe munem me i pa mundësitë edhe pse ju e patë që buxheti për investime kapitale veq osht shumë i vogël tre milion edhe na nuk munem me e nda. Nuk kam kërkesë unë që keni pas naj..

Hajdar Sutaj

Kështu kolegë, e kuptoj, e kuptoj, e kuptoj. Po du për me thonë që, e keni, e keni pas gjithsecili drejtën e fjalës edhe e keni mundësinë edhe replikes. Po Florim Mataj e ka fjalën tash. Kisha lutur që me e kalu fjalën te Florimi. Florim me falë, për shkak edhe procesit afro ma shumë mikrofonin. Dheze dhe njëherë mikrofonin. Veq afro mikrofonin, veq afro.

Florim Mataj

Përshëndetje kryesues, përshëndetje të nderuar kolegë dhe kolege, drejtor. Sot po flasim për kornizën afatmesme buxhetore 2026-2028. E dimë gjithë këtu që shumica e projekteve janë në vazhdimësi që i kemi votuar edhe në vitet e kalume. Por që projekt i ri, ndërtimi i kanalizimit në fshatrat e komunës së Deçanit, e kom ngritur në Komision Politik dhe Financa. Besoj i dha disa sqarime kryetari, shpresoj që të ndodh, se e dijmë që është një kosto e madhe që nuk mund të përballoj komuna jonë. E kom ngrit drejtoreshë edhe në komision politik e financa **[nuk kuptohet]** e Bjeshtës së Belegit. Kom kërku që të shiqohet edhe një aneks që të bëhet edhe leksimi, ndoshta në Bjeshtë te Baballoqi, Prilepit apo Isniqit, në bjeshtë ku ka mundësi që të shkon rrjeti i rrymës. Ndërsa sa i përket projekteve tjera, nuk kisha dashtë diçka mu nderlidhe, e dijmë edhe buxhetin që e kemi, mundësitë janë këto që i kemi. Disa projekte i diskutoi edhe kryetari i komunës që do të jenë bashkëfinancim me nivelin qendror. Dashta me u nderlidhë te një temë që pe rrethim shumë herë, ujit në komunën tonë. Na të gjithë jemi te vetëdijshëm këtu dhe e dijmë që menaxhimin e ujit në komunën tonë nuk e bon komuna Deçanit, osht Hidrodrini dhe njesia në Deçan. Kështu që, të lutna ta përfundojë, kur ta përfundojë atëherë kërkuj si ndërhyra, unë po du me e përfunduar, unë kam drejtën time, fjalën time, sikur keni drejtë me na sulmu ju, unë du me e mbrojt ni diçka që kam të drejtë, kështu që të bëhemi më të arsyeshëm. Po du me u ndërlidhë edhe njëherë te kjo pike, të gjithë na e dijmë se në kompetencë të kujt është, e kemi ngritur disa herë komisionin në asamble, kemi diskut disa here, kemi shku te Drini në Pejë, dhe asnjëherë nuk kemi marr ni përgjigje. Kështu që në aspekt te menaxhimit mund ta, ta ngrisim naj projekt në fshat ku ka nevojë të bëhet infrastruktura, sa i përket menaxhimit të ujërave në komunën tonë nuk është në kompetencë të kryetarit, as, as të komunës së Deçanit. Kjo është mase e qartë dhe e dijmë të gjithë. Këta dashta me e ngritë, dhe, nuk e kemi në kompetencën tonë, se po ta kishim në kompetencë, besoj se do kishte ndodhur ndoshta, sikur është kompani pastrimi në komunën tonë do të kishim furnizim ndryshe me ujë të pijes. Kaq kisha.

Hajdar Sutaj

Ju falenderoj shumë, Hyrije Dobrunaj e ka fjalën, meqënëse ka diskutu vetëm si shefe e grupit.

Hyri Dobrunaj

Si shefe e grupit, ti e pe kryesues që unë nuk du me u zgjatë, sepse edhe të tjerë asambleista duhet me ju lënë mundësinë gjithmonë se kanë me thënë diçka, po e kam një pyetje. Në qoftë se na në projeksionet buxhetore kemi ndarë para për ujësjellësin në Bjeshkën e Madhe, a më tregon dikush tash, kush e menaxhon ujin në bjeshkë e kush në rrafsh. Se nuk po mundem me kuptu ?

Hajdar Sutaj

Besoj që edhe ju e dini që obligimi i komunës është me kry infrastrukturën ndërsa furnizimin dhe menaxhimin e ka Drini I Bardhë ju e dini këtë punë ju e dini, Florim rregullat janë përgjithëshme, Drejtori Izet Zenuni nëse nuk gaboje ka kërkuar fjalën më fal se e ka kërku njëjtën edhe Albësë nëse bini dakord dytë me fol në rregull, apsolut është shumë e vërtetë jo jo nuk ja dhash fjalën, fol Izet. Drejtor Izet, shiko nëse folim si kemi qef po folim, si është ju e dini si është tash për kamer është ndryshe Izet Zenuni e ka fjalën drejtori I Shërbimeve Publike

Izet Zenuni

Faleminderit kryesisë shumë mirë edhe qartë e din edhe asambleistat që e ngritën temën e ujësjellësit që komuna i ka kompetencat e ndara prej Hidrodrinit. Komuna e ka kry punën e vet momentin që ka zgjatë infrastrukturën 100% drejtorit të komunës së Deçanit do të thote e ka çu gypin e ujësjellësit furnizim ndërsa furnizimi, menaxhimin, mirëmbajtjen është kompetencë e qartë e dini secili asambleist që është kompetenc e Hidrodrinit edhe taksat e pagusve që e paguajn ujësjellësin e pagujn te Hidrodrini dhe ata janë përgjegjës për me shperda ujin me mirmbajt dhe me menaxhu rrjetin tash është tjetër gje forma tjetër që e perdorim ne për fushata të caktume por deri sa komuna 100% e ka shpërnda rrjetin e ujësjellësit në teritorin e Deçanit e ka perfundu në anën tjetër obligimin e vet ndërsa bashkpunimi me Hidrodrinin është temë tjetër ju e keni ngrit komisionin e tha edhe Florimi, komisione at`hok keni kontakti me Hidrodrinin përgjigja u kanë e njëjtë prapë situatë u kan si në fillim dashta më herët dikush e potencoj një asambleist te kryetari nuk raporton për punën që bën është raporti vjetor I kryetarit që është I detajuar për secilin punë që e bënë brenda vitit Deçani pas luftës ka trashëguar 16 kilometra asfalt sot I ka 408 kilometra asfalt, Deçani ka trashëguar 0% ndriqim public sot I ka 90% Deçani ka trashëguar pasë luftës 0% ujësjellës sot I ka 100% dhe mos te flasim edhe për tema tjera që janë nuk është zi krejt nuk ka trotuare nuk ka parqe nuk ka rrugë nuk ka asfalt nuk ka ujësjellës nuk ka kanalizim e kuptoj që kemi hyrë fazën e fushatav por pak duhet me qenë më të qart.

Hajdar Sutaj

Më falni nuk ka përmendur emra kërkoj falje e ka kerku fjalën Florimi etj nëse ju jeni dakord me shkel unë rregulloren në këtë pike me ja jep fjalën nga Florimi te Yllartta që është duke e kërkuar prej Albësës, Hyrija dhe Fatoni atëher po e bëjë flisni të gjithë edhe nga 1 minut nëse doni, a ka dikush që nuk ka diskutuar e qes në votim.

Kush është për?

A ka kundër?

A ka abstenim?

Atëher me 12 vota për me 6 vota kundër me 3 vota abstenim Kuvendi Komunal e ka miratuar për me vazhdu në procedura të më tutjeshme korniza buxhetore afatmesme 2026-2028 qv I nënshtohet debateve publike pastaj vjen për diskutim përfundimtar edhe shqyrtim edhe miratim në kuvendin komunal, jemi tek pika e tretë, e dyta e rendit të ditës.

Shqyrtimi I raportit të auditorit të jashtëm për ndërmarrjen publike locale Higjiena këtu e kemi kryetarin e komisionit të Aksionarëve zt. Shkodran Mustafa dhe I kemi po ashtu kolegët nga ndërmarrja zt. Sali Kuqi me bashkpuntor të cilët janë të gatshëm me diskutu, nga grupi I Aleancës kush dëshiron të diskutoj për kete temë, jo jo.. kush ka për me fol raportin e keni Arian Dobraj e ka fjalën.

Arjan Dobraj

Faleminderit për fjalën kryesisë realisht unë prita me degju diçka nga dikush, kështu keshi i përgatitur edhe vetë me dëgju diçka sepse raportet ne I lexojmë dhe kuptohet që krijojm njëfarë lloj mendimi. Opinion pakualifikuar kështu po shkrun edhe në krahasim me atë qka ofron Higjiena sepse harrova mi pershendet disa nga punetoret e adeministrates perfaqësuesit që janë këtu sot me ne të cilët I falenderoj që e kanë marr

mundin dhe kan ardhur në seancën e kuvendit komunal, faktikisht në faqen 6 deklarata e pajtueshmeris që në fillim në rreshtin e dyt pasqyrat financiare për vitin raportus 2024 paraqesin një pamje të drejt dhe vertet të pozitive financiare të rezultateve të operacioneve dhe rjedhave të paras në pasqyrat financiare që janë përgatitur në pajtim me të gjitha kërkesat e ligjit 06L-032 për kontabilitet raportim dhe auditim, kundërshtimi është menjëherë i auditimit në faqën 4, Kompania nuk e ka rishikuar asnjëherë të vetme thotë e ka cek shumë mirë asnjëherë të vetme vlerën e drejt të aseteve siq kerkohet me modelin e rivlersimit nga standardi nerkombetar i kontabilitetit të pasurive afatgjate materiale domethan ata kanë kerkuar që të bëhet një rivlersim në mënyrë të rregullt dhe të mjaftushme që të sigurohet vlera kontabël e pasurisë natyrisht është një pjesë e rëndësishme sepse për këtë pjesë bëhet realisht edhe pasqyra e auditimit për momentin nuk kam diqka për më shtu.

Hajdar Sutaj

Jo pate boll urdhëro Hyri Dobrunaj e ka fjalën

Hyri Dobrunaj

Aq shumë po më pëlqejn sot kolegët në asamble, kisha dashtë që për çdo vitë me kon vitë zgjedhor me kon aktiv secili, është shumë e shëndetshme për demokracinë dhe për qytetarët unë du me ja kalu fjalën Vatanit me qenë se është shumë pak para fushatës e keni vërejt ndoshta që kom fol kater vite mjaftueshëm për çdo herë tash e kanë radhën tjerët me u ekspozu para fushatës.

Hajdar Sutaj

Atëherë Vatan dëshiron të ekspozoj urdhëro, merre fjalën Vatan

Vatan Istrefaj

Kryesues për ekspozim jam sa të duash mos ta ndin për atë punë, qytetarët e vlerësojnë atë pjesë, sa i përket raportit të jashtëm të auditorit për ndërmarrjen publike lokale Hixhena, kemi shumë çka me folur së pari përshëndetje zyrtarë të Hixhenës që janë sot këtu, në kryesuesin e bordit si të e marrim dhe e shikojmë raportin auditorit e shohim se është i bërë nga një auditor privat pra është Pro Audit, Auditori jashtëm një auditor që ska jap shumë sqarime apo rekomandime në këtë pjesë si për shembull unë duhet ti kërkoj disa sqarime. Sqarim për detyrime tjera afatgjate është e cekur tek shenimi numri 10 le të majnë të shënuara ata që kanë me u përgjig te hyrat e shtyera nga grandit 380 mijë euro. A ka mundësi me pyet nga kush është ky grant? Çfarë është blerë me të? Për çfarë është përdorur? Po ashtu e shoh se kemi rritje të llogarive të pagueshme mbi 80 mijë euro. Na shpjegoni këto llogari po ashtu, kërkoj rritjen e llogarive të argëtushme mbi 200 mijë euro nga viti i kaluar nga viti 2023 domethënë në vitin 2004 llogaritë e argëtushme janë rritur mbi 200.000 euro që në total janë mbi 500 mijë euro, llogaritë e arkëtueshme pra a ka mundësi me na shpjegu neve kush ja ka të gjitha këto borxhe ndërmarrjes, a është komunë, pasi që ne dimë se qytetarët janë taksapagues shumë të rregullt në ndërmarrjen publike Hixhena po ashtu kërkoj nga menaxhmenti letrën me sqarime dhe rekomandime për ndërmarrjen pasi që ajo nuk është mbi të gjitha është një auditor që është kontaktuar vetë nga Hixhena dhe nuk po e shohim shumë serioz që të diskutojmë me shumë me të. Faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit, e kam përshtypjen që duhet me kan negative me ju pëlqy, Urdhëro Orges, Orges Tafilaj e ka fjalën.

Orges Tafilaj

Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë, pyetjet dua te ja adresoj komisionit të aksionerëve fillimisht është në rregull që opinioni është i pakualifikuar, megjithatë unë besoj që ky raport që na ka ardhë, ma shumë ka faqe të tëra të termave ose sqarimeve të termave të përgjithshëm që secili prej neve mundet mi gjet në një search në Google realisht. E dyta, pyetja që shtrohet kur kemi të bëjmë me raport auditorit cilat janë gjetjet? Nëse gjetje ska atëherë cila janë rekomandimet e këtij auditori për kompanin tonë? Fillimisht është se të hyrat e kompanisë nga viti 2023 në 2024 janë rritur rreth 150.000 euro por problemi ma i madh është që janë rritur llogaritë e arkëtueshme për 240.000 euro domethënë kompania ka kry punë ma shumë por nuk i ka marrë lektë nuk i ka marrë pagesat për punë që ka kry dhe të njëjtën kohë janë rritur llogaritë e paguashme këta terma na tregojnë që kompania realisht performon mirë por ka probleme likuiditeti ka probleme të theksuara likuiditeti në dy anët e para nuk mund ti paguj borxhet e cila rritet e dyt nuk inkason pagesat për punë që ka kry dhe normalisht që Komisionit të Aksionerëve, në takimet me bordin e kompanisë, i kërkohet që këto dy terma të shikohen në mënyrë që kompania të operojë mirë edhe të vazhdojë punën e saj. E dyta në faqen 14

është cekur si është bërë vlerësimi dhe është bërë me standardet e kontabilitetit megjithatë ka mospërputhje përderisa asetet janë 284 mijë euro dhe zhvlerësimi është 65.274 është një diskripancë e vogël që realisht pyetja që drejtohet është, a ka ndonjë pajisje që ka dalë nga funksioni apo si është puna, në fund për dallim nga herat e tjera që na është thënë nga raportit i auditorit që kompanija ka rreth 53 punëtorë që nuk ka qenë në rregull sepse kompania ka numër të saktë të punëtorëve kësaj radhe nuk e kemi këtë informacion fare prandaj pyetja është sa punëtorë ka kompania dhe krejt në fund inkurajoj komunën që për punë të cilat kompania mund ti kryejë ti orientojë sa ma shumë nga kompania Hixhena faleminderit!

Hajdar Sutaj

Faleminderit Orges, Mon Selmanaj nuk ke diqka, Shkodran a ke diqka me than? Shkodran Mustafaj e ka fjalën, nëse eventualisht ke diqka për me shtu është edhe Sali Kuçi ketu prej ndërmarrjes.

Shkodran Mustafaj

Përshëndetje për gjithë përshëndetje kryesues këtu e kem ni raport auditorit të jashtëm për ndërmarrjen Hixhena domethënë është kompania Pro Audit. Kjo përmes prokurimit është edhe publike që ka marrë ni kontratë me Hixhenën tash a e ka kontakti Hixhena aty kan qenë oferta të hapura nuk besoj edhe nuk menoj që është veç një operator ose veç një kontraktor që ka apliku, po janë ma shumë se tre që ligji e thotë që duhet me konë më shumë se tre ka qenë një komision që ka bo vlerësimin që ja ka jep kontraten Pro auditit për me bo auditimin e jashtëm të Higjienës këtu shihet që një opinion i pa kualifikuar është që gjendja nuk është keq kemi të hyrat që janë rritë të hyrat kemi edhe obligime domethënë që janë edhe kontratat mes Qendrës Komunale edhe Higjienës domethënë ka të rritura edhe ka shpenzime më shumë. Pyetje tjera domethënë që keni diqka ju kisha lutë e kemi edhe zyrtarin, shefin e Komptabilitetit Sali Kuqin që ndonjë pyetje qe nuk mundemi me sqaru në detaje, është edhe ky ndoshta na jep ndonjë sqarim edhe pyetje tjera që mundem edhe me i adresu te Sekretariati me shkrim mundemi bo edhe ni takim me shku në Higjienë, me kërkua dokumenta shtesë me kërkua... qfarë të është e nevojshme ne jemi të hapun, faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë realisht vetë fakti që raporti është i pa kualifikueshëm nënkupton të gjitha, ne obligimet që i ka komuna është mirë mi kry sigurisht po absolut fokusohuni te raporti te të gjeturat e raportit, tash me qenëse shefat e grupeve diskutun Miftarit e ka kërkuar fjalën Miftar Ahmetxhekaj.

Miftar Ahmetxhekaj

Falemnderit shumë kryesues unë shkurt me qenëse edhe në seancën e kaluar e kam shtrua si pyetje opinionin është i kualifikim pa kualifikueshëm që është pozitiv, ndërsa në faqen tre, në paragrafin e dytë, auditori kur fillon fjalimin thotë "për mendimin tonë" që mu këtu tash më krijon dilemë edhe... Shkodran, e di që besoj në profesionalizëm unë veç një pyetje kam megjithatë u përgjigje pak, neni 33 i ligjit për ndërmarrjet publike e parasheh ose e parafrazon se si angazhohet një auditim përmes procedurave të pkrimit unë e kam një pyetje konkrete.

A ka pas procedura të pkrimit që spo du me dyshu që ska pas? Po a kemi mundësi me pas qasje të interesuarit se si janë zhvillu këto procedura? A ka pas konkurrense? Edhe thjesht është ligjore kaq po du. Nëse, e din, nashta... Për shkak, ëh, dilemat, dilemat mi krijon, mi krijon qysh në hyrje. Auditoret nuk guxojnë ose nuk kanë të drejtë me, me kriju mendim e konstaton ose se konstaton ka pasqyra të sakta ose nuk ka të sakta falemnderit shumë.

Hajdar Sutaj

Faleminderit Shkodran Mustafa e ka fjalën prap.

Shkodran Mustafaj

Po koleg ka pasë domethënë kanë qen më shumë se 3 ofertus sipas të dhënave kan qenë 8 ofertues domethënë edhe ka qen një komision që ka bo vlerësimin edhe ka qen ofertusi më i liri që ka marrë ofertën për me kry auditim e Higjienës domethënë ka pasur procedura e prokurimit janë publike nuk di a janë në faqe të Higjienës, po ka qasje kur ju e vlerësoni domethënë që mendoni mundem me shku me i gjet ato... ka procedura të prokurimit.

Hajdar Sutaj

Po, Faton Selmanaj e ka fjalën.

Faton Selmanaj

Përshëndetje për gjithë faleminderit kryesues unë po l bi shkurt mendoj qysh paska mendu edhe ky zotriu që e ka bo këtë dokument që Komisioni i Aksionerëve duhet me pas përgjigje për secilën pyetje dhe njëkohsisht mendoj dhe i bëjë thirrje Prokurorisë së Shtetit që ta hetoj këtë dokument se ka material të mjaftushëm për hetime faleminderit.

Hajdar Sutaj

Dikush tjetër? Sylë urdhëro Sylë Balaj e ka fjalën

Sylë Balaj

Këtë pozicion auditori e ka cekur vetë shpenzimet tjera janë mbi 52.000euro, qfarë janë këto shpenzime? Pasi që auditori nuk ka japur shpjegime tjera shtesë faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit Shkodran, nëse donë është edhe Saliu që mundet me dhënë përgjigje, Shkodran Mustafaj e ka fjalën.

Shkodran Mustafaj

53.000 janë shpenzimet e mirëmbajtjes të gomave të kamionëve, mjeteve motorike, domethënë janë shpenzime të këtyre mjeteve domethënë nashta nuk janë te detajume kejt kështu, po, domethënë, qatu jonë shpenzimet të mirëmbajtjeve të mjeteve motorike.

Hajdar Sutaj

Faleminderit Shkodran, Florim Mataj e ka fjalën të lutna afro mikrofonin afro ma afër.

Florim Mataj

Unë dashta me diskutu e ngriten shumica e diskutimeve që u bënë opinionin është l pakualifikuar por ka shumë **elemente pozitive** unë pik së pari ndoshta kisha dashur me falenderu gjith atë punë që bëjnë ata puntor në teren duke përfshir edhe stafin menaxher por kërkesa ime kryesore ishte që stafi menaxherial udhëheqësia ti marin për bazë opinionet e auditorit dhe që ne të ardhme mos të na vije një raport l auditorit sikurse na ka ardhur sot dhe e dim të gjithë se 100% aksioner është komuna e Deçanit e ka ngritur disa here këtë shqetësim ndoshta ka ardhur koha që viteve ne vazhdim tja kthejë dividenden edhe aksionerit kryesor që është komuna e Deçanit

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë, Vatan Istrefaj e ka fjalën

Vatan Istrefaj

Falemnderit kryesues unë personalisht me gjithë respektin për Shkodranin dhe gjithë zyrtarët që janë këtu prej Higjienes unë nuk e morra asnjë përgjigje a dinë veç po shkojnë duke fol herë aj e herë ky a ka mundësi me marrë ndonjë përgjigje prej atyre pyetjeve që i bëjmë? Apo ka mundësi me përsërit edhe njëherë apo me ja u dorëzime të shkruara të dime këtë, po ashtu edhe një pyetje shtesë e kisha bërë kemi parë që tash kryeshefit l ka kaluar mandati edhe l ka kalu pozita e ZKA-s zonjushes Albana a ka mundsi pse si ka kaluar kryeshefit e zavends kryeshefit aty pse u bë kjo shkelje ligjore apo gjithë duhet me shku me kësi shkeljesh si në QKMF si në Higjien gjithmon jeni recidivista faleminderit.

Hajdar Sutaj

Përbesë nuk po e dishe se në qdo ndërrmarje si të kalon kryeshefit me ligjë është ZKF-ja emërohet në rregull urdhëro Shkodran

Shkodran Mustafaj

Po Vatan mandati kryeshefit l ka kaluar dhe zyrtarja kryesore financiare është ushtruse detyre deri të përzgjedhet kryeshefi domethan përmes procedurave, e pyetjet mundësisht nëse l ke të sekretaria l delegon mundemi me shku edhe në Higjien me l lyp edhe dokumentat shtes domethan jemi të hapur për me vazhdu

Hajdar Sutaj

Drejtori Izet Zenuni e ka fjalën.

Izet Zenuni

Pyetje per Shkodranin a ka qen operatori I licensuar qe e ka bere auditimin atëherë të lutem te gjitha këto vrejtje te auditori I licensum qoft privat qoft jo professional po me duket se krejt jan llafe edhe një sqarim kryesues dashta, është auditori I licensum I zgjedhur ne menyrt te rregullt permes prokurorimit edhe tash në qoft se dyshoni në aftesi profesionale te auditorit I cili është I licensuar prej niveleve tjera është temë tjetër edhe diqka tjetër kryesues, te perzgjedhja ushtrus I detyres te kryeshefit të Higjienës (....) I kompanisë nuk e percatkon zevendsin as nenzavendsin e kryeshefit është bordi ai I cili e emëron ushtrusin e detyres deri ne procedurat e zgjedhjes se drejtorit ose shefit egzekutiv

Hajdar Sutaj

Koleg faleminderit për kontributin e kalojmë si temë jemi te pika e treta që është shqyrtimi i planit ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave për pesë komunat e rajonit, Dukagjinit, Pejë, Klin, Istog, Deçan, Junik 2025-2035 Drejtor fjala për ty Drejtori Izet Zenuni e ka fjalën, nuk ish aj djali e kish mshel as nuk po lajmrohet as kurgjo, e ka fjalën drejtori Izet Zenuni, drejtor Sali, zt Hajdaraj, falimnderit shumë me respect e punë të mbarë.

Izet Zenuni

Po kryesues faleminderit materialin e kini marrë, është material kogja I madhë kogja I detajuar specifik, ky plan ndërkomunal, që komuna e Deçanit ka hyrë në një fazë tjetër te menaxhimi i mbeturinave do të thotë, eh, për vitin 2025-2027 momentin që ky plan kalon edhe fillon me u implementu, Gizi ka një plan të veprimit, për pesë komunat do të thotë, ne si komunë nga viti 2025-2027 do të jenë përfitues dikun te një vlere afër 2 miliona euro do të thotë është e parapame oborr riciklus që do të fillon këtë vitë 382.000 euro është se pajisjet për kompostim është 234.000 euro për mbeturina inerte 204.000 mijë euro edhe për stacion transferi 726.000 euro duke mos i përfshirë edhe katër kamionë të ri që kanë janë parapa në pjesën e grandit vitin e ardhshëm në fillim do të pajiset komunat e Deçanit. Do thotë momentin që këtë vitë kalon procedura përkurorimit për pikë transferit, do thotë që kompani Higjien do të ja lehtësojë edhe qoftë transportin, qoftë koston e mirëmbajtjes, qoftë koston e kohës kjo pikë transferit ka me ulë edhe shpenzimet e derivatev edhe pjesë tjera te harmotizimit qoftë asaj unë e kisha kërkuar nga ju me kalu në lexim të pare me ju nënshtu diskutimit publik ndërsa për në korrik me e përmbyll si dokument propozimtar.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë edhe përgëzime edhe për rregullorën po edhe pop na bika mirë edhe për këto investime, te cilat planifikohen më ndodh. në emër të grupit të Aak-s Florim Mataj e ka fjalën.

Florim Mataj

Shumë arsyeshmeri na dha drejtori....shpresojm që në vazhdimsi të japim edhe ne kontributin tonë ne si grup I Aleancës kështu që ne në parim e mbështetëm

Hajdar Sutaj

Falemnderit shumë nga Ldk-ja Hyri Dobrunaj

Hyri Dobrunaj

Në parim edhe grupi i Ldk-së e mbështet me qenë se na skemi pas kohë me lexu këtë material është e vërtet unë kam veç një pyetje, këto pikat e grumbullimit të mbeturinave në cilën komunë janë të parapame, me qenë? Veç kjo më intereson, pastaj nëse dojmë me dhënë kontributin duhet me e lexu këtë material sepse nuk e kem lexuar.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë drejtoreshë, Izet Zenuni drejtori ka fjalën.

Izet Zenuni

Po faleminderit për pyetjen është pika, deponia e kryqësor do të jetë në Pejë, që BE-ja i ka ndarë 16 milionë euro fonde për revitalizimin e saj do të thotë ne si komunë e Deçanit do të jem përfitues te stacioni i transferit, do të thotë do të jetë stacion i transfer ditor, që gjatë ditës grumbullimi i mbeturinave bëhet ne stacion

transferit dhe mbrëmjet me ni kamion transportohet direkt në deponi regjionale në Pejë, ndërsa pjesë e stacionit transfer do të jetë edhe Juniku do të thotë do deponon mbeturinat ditore ne stacion të transferit, ndërsa transportohet mbrëmjen ne Pejë.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë drejtor Orges Tafilaj prej Vetëvendosjes.

Orges Tafilaj

Faleminderit kryesues faleminderit për sqarimin drejtor, leximi ka qenë shkaras spo kuptohet megjithatë desha të jep disa vërejtje të shkurta. E para faqe 46 është mirë që të përmendet jo si ndërmarrje komunale vetë qysh është përmend po të thuhet se është ndërmarrja Higjiena qysh ka përmendur ambientin Peja. Pjesa tjetër të dobësit në faqen 40 të dhënat që janë përdorur janë vitit 2014, që besoj që mund të riazhurnohen për shkak se ka të dhana statistikore ma të reja dhe njëkohësisht njëjtën faqe janë përdorur të dhëna për mbeturinat për kokë banori për vitet 2021-2022 besoj që i kemi 2023-2024 dhe besoj që duhen të ndrrohen parimisht e përkrahim që dokumenti të del në dëgjim publik, si grup i Lëvizjes Vetëvendosje faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit Orges, Mon Selmanaj e ka fjalën

Mon Selmanaj

Pas sqarimeve që dha drejtori edhe unë e mbështes këtë projekt

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë Mon a ka dikush tjetër që dëshiron me diskutu në lidhje me këtë pikë prej anëtarëve të Kuvendit? Po Miftar Ahmetxhek a kishe diçka për te thene?

Në rregull e qes në votim.

Kush është për?

A ka kundër?

A ka abstenim? Konstatoj që Kuvendi Komunal në mënyrë unanime i ka dhënë mbështetje që me vazhdu procedurat me planin ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave, jemi tek pika katër shqyrtimi i kërkesës së kryetarit të komunës së Deçanit zt. Bashkim Ramossaj për ndarjen e njëj hapsire, për ndertimin e objektit për nevojat e shoqatave të dalura nga lufta Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës Dega-Deçan e kemi këtu edhe drejtorin Izetin edhe drejtoreshën Dafinën, që i kemi diskutu edhe në mbledhje të KPF-s e hapi diskutimin në emër të grupit të Aak-s do të flet shefi i grupit Arian Dobraj, Yllarta Thaqi e ka fjalën në emër të grupit të Aak-s

Yllarta Thaqi

Faleminderit shumë në emër të grupit të Aleancës përshëndesim iniciativën për ndarjen e një lokacioni për ndërtimin e shtëpis së vlerave të luftës UÇK-së edhe në KPF e kemi diskutu lidhur me numrin e parcelave të cilat janë të ndarë me këto me zero ni, zero dy, zero ni, zero zonë katastrale Deçan, ose disa numra tjerë të cilët kanë qenë pak si të paqartë se kanë qenë gjithë këta numra është, kemi marrë edhe përgjigjen pse kanë qenë gjithë këta numra për shkak të ndarjes te këtyre parcelave por sido që të jetë ne si grup i Aleancës e përshtëndesim iniciativën dhe urojmë që edhe buxheti i miratuar të jetë në favorin e ndërtimit të kësaj shtepie e cila ka shumë vlerë dhe shumë rëndësi për gjithë komunitetin faleminderit shumë!

Hajdar Sutaj

Faleminderit Yllarta prej grupit Ldk-s shefja e grupit Hyri Dobrunaj.

Hyri Dobrunaj

Patjetër që edhe grupi parlamentar i Ldk-s e mbështet këtë kërkesë të kryetarit dhe jemi të kënaqur që është ndarë edhe buxhet për këtë shtëpi e veteranëve. Mirëpo ne kemi pas disa paqartësi sa iu përket këtyre parcelave, i kam edhe sot, sepse me sa e di unë vizualisht, në bazë të kësaj skice, ajo toka është mes ambulantës se vjetër edhe mes kësaj shtëpisë dhe në Deçanë brenda qytetit nuk ka tokë bujqesore klasës katër edhe tre qysh është e shënumë në njësi katastrale nuk ka tre edhe katër, qashtu e keni shënuar edhe për një pjesë kam pas paqartësi, që është diku 1 hektare e 200 ari përpos këtyre pjesëve tjetra, unë nuk e di a është krejt që ajo hapësirë aty aq e madhe edhe kemi kërku diçka shtesë për me na u sqaruar për sot po nuk kemi marrë diçka shtesë.

Hajdar Sutaj

Falemnderit shumë Hyrije, nga grupi I Vetvendosjes Faton Selmanaj

Faton Selmanaj

Edhe ne në parim e mbështesim por edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë e Financa kam kërkuar sqarime shtesë për parcelën zero ni, zero dy ni vizë ni ku janë 12.976 metra, e në të cilën thuhet si dhe një pjesë e parcelës. Në Komision për Politikë e Financa na u ka thonë që na vjen si e saksume kjo, por sot nuk ka ardh kështu që a mundeni me na tregu tash për sa hapësirë prej kësaj parcele, domethënë prej hapësirës dymbëdhjetë 12.976 metra ka mu marrë e me ju bashkangjit këtyre tri parcelave tjera.

Hajdar Sutaj

Falemnderit shumë Faton, Mon a ke diçka me thane, Mon Selmanaj, drejtoresha Dafina Cacaj e ka fjalën

Dafina Cacaj

Po kemi diskutu në mbledhjet e KPF-s dhe jemi zotuar që kemi me pru hapësirat e përcaktuara sa ka me qenë e nevojshme për këtë në jam interesu por nuk ka projekt detal që unë me dit është faza fillimtare që me ditë sa metra ju duhen atyne për me, m-me kry komplet projektin e tyne është fillimtare kjo çka është ardh edhe nuk kemi të përcaktuar, por mirëpo aq sa ju nevojiten do kryjm me aq sa është e votume ose nëse votohet këtu po nuk nuk kam shumë të përcaktume me sa fiks metra ju duhen.

Hajdar Sutaj

Po patjetër patjetër e ka fjalën Faton që e ngriti si temë pastaj Miftari, Faton Selmanaj

Faton Selmanaj

Drejtoresh përderisa janë kërkuar është kërku pronë prej katër parcelave qysh nuk dihet qysh nuk është projekti realisht ish dasht me kon projekti që me qenë qe me thanë me ditë kogja afërsisht se sa prona i duhet e pastaj me votue përndryshe jo unë kam dilema se si me votu përderisa nuk e di saktë se çfarë projekti ka mu bo aty, dhe sa hapësirë i duhet atij projekt.

Hajdar Sutaj

Miftar Ahmetxhekaj e ka fjalën krejt ajo hapësir nëse ju duhet krejt sështë ajo ndonjë hapësir e madhe.

Miftar Ahmetxhekaj

Falemnderit shumë kryesues për afërsisht edhe unë i kam të njëjtat drejtore bëhet fjalë për katër parcela, të cilat ne vijnë ndërtimore nuk janë të rregullta, me thënë janë të çrregullta për shkak se kanë edhe 017 në mes këtu bëhet fjalë për një objekt që ne të jemi korrekt me veten absolut nuk jemi kunder po parimisht është dashur të jetë bile një situacion ku ka mu vendos ai objekt a bëhet fjalë e vërtetë për një objekt? A po kanë kërkesa edhe të tjera? Nëse eventualisht kanë pasur kërkesa të tjera? Ai objekt nuk mundet mu shpërndarë në tri parcela. Dhe plus është, është kërkesë për parcelën e katër. Një pjesë u tha prej kolegëve Është mirë ti specifiku sa metër katror i duhet prej parcelës numri 21. Unë nuk po du se shefja veç e tha që ne e mbështesim parimisht parimisht ish dasht të vijë një projekt ideor se çka vërtet ka me u vendos të jemi ne korrekt me veten te dim çka po votojmë

Hajdar Sutaj

Falemnderit Miftar, Florim Mataj e ka kërkuar fjalën.

Florim Mataj

S'tej, syt sen se kemi gjith kuj jon specifiku pak jon bo me tejk tri parcela që bëhet fjalë dyqind e katër vende që me gjatë vende edhe shtat qirond e gjashtë shtat metra katror shihen sej katy. Kështu që naje ne e kapim. Besej n'parim parcelën normal kur bëhet një projekt ka mundohesh kem me votu prap edhe ne perkrah se kjo osht kështu. Nuk shkon mënyre ka mu bo ni komision që ka me bo. Shiqjen procedura tjere vazhdimsisht. Nuk tregoni diçka që nuk do kalon veç ke myne. Veç veç thjesht të ndajmë një lokacion ku ndoshta do dalin gjodrat e ta bojnë projektin dhe ta vinë te na prap. Po jepni për Asamblee ka mu bo komisioni.

Hajdar Sutaj

Falemnderit Florim, Orges Tafilaj e ka fjalën.

Orges Tafilaj

Faleminderit kryesys personalisht besoj që zyrat e OVL-së në pallatin e Kulturës nuk janë reprezentative dhe normalisht që pajtohem që ka nevojë për një objekt të ri. Pytja ime e parë është, a ka pasur kërkesë nga organizatat e dala nga lufta për një objekt të tillë? Dhe pytja tjetër, nëse ka pasur ka qenë mirë me na ardh si dokumentacion dhe pytja tjetër, a pajtohen me lokacionin që po flasim? Faleminderit.

Hajdar Sutaj

Orges Faleminderit drejtoresha Dafina Cacaj e ka fjalën

Dafina Cacaj

Kërkesë të shkruara nuk ka pasur, mirpo ka qenë kërkesa e atyre që me qenë jajo pjesë përmes neve më ardh kërkesa të ju për qat parcelën ku është e përcaktuar edhe në kërkesë, mirpo të shkruara diçka nuk kam pasur se patjetër e kishim bashkangjit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë për kontributin, për komentet dhe e qes në votim.

Kush është për?

A ka kundër?

A ka abstenim?

Konstatoj që me 20 vota për, me 1 abstenim e kemi kaluar si pikë të rendit të ditës edhe e kemi votuar si lokacion për ndërtimin e objektit për nevojat e shoqatave të dalura nga lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Kolegë, shumë prej juve më kini shkruar mesazh me majt pauz.

Pika gjashtë shqyrtimi i draft rregullores për organizimin e brendshëm, a bon pak vëmendje nëse ju doni me mbajtë pauza, mbajmë pauzë nëse nuk mbajm pauz koncentrohuni mos bëni zhurmë edhe ta kryjmë kështu e kemi shqyrtimin e draft rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në administratën komunale e kemi këtu zotrin Enver Cacaj që është shëf i sektorit për burime njerëzore po ashtu draft rregulloren e keni marrë bashkë me material edhe në email edhe në kopje fizike e kemi pasur edhe diskutim edhe mirëkuptim të plot edhe me zotrin Enver Cacaj edhe me kolegët e KPF-së, që në draft rregullor të përfshihet edhe Kuvendi Komunal kjo e ndihmon shumë që edhe ato pengesa që i patëm në fillim për mos me pas sa i përket procedurave të tjera që janë të nevojshme fillimisht e kisha kaluar fjalën Enverit, Enver a do me fol, Enver Cacaj e ka fjalën edhe pastaj e hapim diskutimin.

Enver Cacaj

Atëhere, përshëndetje për të gjithë, Komuna e Deçanit besoj që keni njohur, i ka angazhuar një ekspert sa i përket hartimit të rregullores për sistematizimin e vendit punës ku qëllimi i kësaj rregullore është organizimi dhe sistematizimi i vendit punës, me arsyete ndryshimit të ligjit për zyrtarë publike dhe ligjit pagave, ku duhet me u harmonizua pozitat dhe përshkrimin e detyrave të punës qëllimi i rregullores nuk është me kriju vende të reja të punës nuk mundemi me kriju vende të reja të punës. Rregullorja e ka parim që këto pozita që i kemi mbrenda institucionit me i harmonizua edhe me i qit me ni fjalë zyrtar ne pozitat adekuate. Sa i përket numrit qysh e potencoj drejtoresha më herët, ekziston mundësia sipas buxhetit me na ul numrin ende nuk mundemi me ditë ai kemi me pas të njëjtin numër, aka me pas uljet te numrit. I nderuar kryesues, sipas kërkesës nga ana juaj që është bërë në KPF e, jemi dakordu ashtu mua mu ka duk pak shpejt, po ajo është e drejte jote që e ke bo per ato pozita, sepse rregulloria në kalon në lexim të parë, i nënshtrohet debatit publik edhe mundemi propozu pozita. Sa i përket prap mbes në parimin tim sipas pozitave që janë propozu nga ana juaj, për sektorin e Kuvendit, pozitat e cekura që janë propozu zyrtari i lartë për përkthime, zyrtari i lartë financiar, zyrtari i lartë lektor, apert mbes pranë këtij parimit që nuk duhet me qenë, me arsyje sepse komuna e Deçanit i ka të planifikume zyrtarin për përkthime dhe zyrtarin për lektorim ku në të gjitha rregulloret e niveleve lokale ju kisha rekomandu hini te shikoni edhe i shihni sa pozita janë të planifikume, për zyrën e Kuvendit Komunal, jo Kuvendi Komunal me pas të veçantë zyrtar për përkthime dhe zyrtar për lektorim ku janë të prapara ne kuadër të administratës komunale te institucionit. Ju kisha rekomandu ti shikoni edhe rregulloret e tjera te niveleve lokale, nëse është naj model i rregullores që o propozu nga ana jonë edhe si I kan rregulloret nivelet tjera locale. Unë mendoj qe nëse kalon lexim të par i nënshtrohet debatit publik atëhë i shohim edhe komentet rekomandimet, qe mundemi me shtu nëse ke diçka më tepër .. po nuk është parim i rregullores me kriju vende t reja të punës.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë Enver sinqerisht e kam thënë edhe në mbledhje të KPF ne nuk kemi kërku vende t reja të punës, veç kemi kërku që e para Kuvendi me u përfshi sepse në rregullore ka fillu me pikën 1.1 kryetari 1.2 thotë drejtoret edhe 1.3 drejtoret e njësive edhe po te them ty qe gjema veç një rregullore që nuk përfshihet Kuvendi atëherë.. 1.1 është kuvendi organi më i lartë 01 1.2 është kryetari 1.3 është drejtoret e drejtërive edhe 1.4 janë shefat e sektorëve edhe nëse Kuvendi nuk ka zyre dhe nuk e ka... komuna ka staf mjaftueshem përndryshe e kemi than, kemi probleme ligjore duhet me pas zyrtar ligjor ka plot jurista qiteni një ne zyrën e Kuvendit duhet me konë ni administrator krej të komisionit, krej të komitetit as nuk mban kush proces verbale, as nuk ka kush i thirrë, as nuk ka kush i organizon duhet me kon ni administrator në kuadër të zyrës. Kemi than që duhet me kon ni lektor, sepse aj lektor është për krejt kuvendin komunal, jo për kryesuesin kjo është në shërbim të anëtarëve të Kuvendit dhe e kemi thonë që duhet për me kon një përkthyes, sepse na qat përkthi që ju thoni ka, unë e kom thirr në zyrë ka thonë unë veq figuroj nuk e bëj, nuk e di atë gjuhë ashtu duhet me pas përkthyes është obligim ligjor me pas përkthyes na nuk jemi duke kërkuar asnjëherë me e punësu na jemi ka dojmë rregullore mu përfshi Kuvendi qysh duhet me kon në (...) me kon Kuvendi edhe me kon, Sekretaria e Kuvendit në funksion merrni kë të doni, kë do që e vlerësoni kushdo që është i përgjegjshëm me kry atë punë le të kalon përndryshe, na kemi me pas probleme anëtarët e Kuvendit nuk kanë me pas mbështetje as komisionit është thjesht krejt kuvendi e ka sekretarin e kuvendit me thonë kështu se është as kjo se ka të definuar pozitën e vet meqënëse është duke u bë rregullorja, le të bëhet rregullorja le të metë në rregullor kur të krijohen mundësitë rregullone këtë qështje në emër të grupit të Aak-s e ka kërkuar fjalën Yllarta Thaqi

Yllarta Thaqi

Faleminderit shumë konsideroj se atë çka e kemi diskutu ne Komitetin për Politikë e Financa i qëndrojmë mbasë saj se 01 duhet të figuroj dhe pa 01 as nuk mundemi me qenë aktive apo mi kry detyrat tona si Kuvend pastaj ne Komitetin për Politikë e Financa e kemi diskutu edhe çështjen e QPS-s apo pse duhet ti hekët udhëheqësi i Zyrës qendres për Punë Sociale dhe të kalojë vetëm tek shefat e sektoreve të cilat i kanë e pash se këtu me ni rekomandim nga KPF-ja ka ardhur që është aprovu edhe kjo, sepse ka ekzistuar udhëheqësi i Qendrës për Punë Sociale dhe pse duhet të mos ekzistojë tani e tutje nëse nuk ekziston udhëheqësi i Qendrës për Punë Sociale, atëherë duhet të largohet edhe udhëheqësi i QKMF-s me ket katalogin e ri të vendeve të punës janë disa fusha të cilat ndoshta janë diskriminu ose disa fusha tjera janë favorizu mbase është si draft edhe kalon në diskutim publik po shpresoj se secila drejtori duhet të japë vrejtjet e veta dhe ti përmirësojë këto në të kundërtën dikush favorizohet dhe dikush ndëshkohet sa i përket këtyre pozitave kaq kam si grup parlamentar shpresoj që askush të mos ndëshkohet dhe asnjë zyrtar komunal të mos mbetet i pakënaqur sa i përket këtij dokumenti, sepse është pagu një shumë goxha e madhe prej 8.500 eurosh që të hartohet një dokument i tillë edhe nëse nuk ju kish nënshtrur diskutimeve publike drejtoritë është dashtë që ta bëjnë plotësim ndryshimin edhe të na vijë i gatshëm të mos hapim edhe diskutime tjera por sido që të jetë, nuk jemi për me e ndëshku askënd jemi për me i rujt vendet e punës nëse nuk kemi me pas buxhet mjaftueshem për me i pagu gjithë punëtorët që janë atëherë vendos niveli qendror jo niveli lokal faleminderit shumë!

Hajdar Sutaj

Falemnderit Yllarta, nga LDK-ja Hyri Dobrunaj

Hyri Dobrunaj

E kemi mendu edhe pse prapë për secilën pikë duhet me kërku falje që nuk e kemi lexu sa duhet nuk kemi punu sa duhet sepse janë dy ditë e këta bashkë me ekspertët kanë bo sigurisht një kohë të gjatë me hartu e na për një ditë me dhënë ni verdikt përfundimtar është pak e vështirë fillimisht e mbështesim kryesuesin i kam thonë edhe atë ditë edhe sot për herë të parë që po pajtohem për diçka është kjo që me figuru Kuvendin këtë draft rregullore sepse nuk është vetëm për pushtetin aktual por gjitha pushtetet që vinë duhet me figurua ajo unë besoj që ish kanë shumë e arsyeshme qe ky draft me u shty mas zgjedhjeve, vijmë ne në pushtet dhe e bojmë edhe ma mirë pa e larguar askënd nga puna faleminderit shumë.

Hajdar Sutaj

Faton Selmanaj nga Vetëvendosja nuk e dita a e pate fjalën për vetëvendosje urdhëro Faton

Faton Selmanaj

Faleminderit kryesues ne i kemi pasë qëndrimet tona edhe atë ditë në mbledhjen të Komitetit për Politikë e Financa kuvendi është organ i veçantë dhe respektivisht e ka të drejtë të mi pasë në funksion edhe shërbimet tjera si i ka edhe ekzekutivi kështu që edhe ne mendojmë që Kuvendi duhet të radhitet i pare dhe pastaj të vazhdojë me të tjerat, kryetarin drejtorit e organet e tjera përndryshe nuk jemi pro kësaj rregulloje sepse veç edhe një moment kryesues, atë ditë na tregova shembuj ku ke pasë konsultime edhe me kolegjiunet e tjera të kuvendeve, te komunave të ngjajshme nga madhësia si ne të gjitha i kanë dhe pse kuvendi jonë mos të i ketë këto mundësi.

Hajdar Sutaj

Falemnderit shumë Mon Selmanaj

Mon Selmanaj

Faleminderit kryesues të nderuar kolegë, te neni 3 I statutit të Komunës përkufizimet na e jepen edhe nocionet si Kuvendi i Komunës është organi më i lartë vendim marrës i komunës që përbehet nga anëtarët e tij të zgjedhur dhe dy, kryetari i komunës është organi më i lartë ekzekutiv i komunës që zgjidhet përmes zgjedhjeve të drejtpërdrejta duke u nisur nga ky fakt dhe nga fakti se në vitin 2012 me një vendim të kryetarit të atëhershëm mbi sistemimin e vendëve të punës hartuesi apo eksperti i angazhuar dhe i paguar me 8.500 euro për hartimin e kësaj draft rregullore e ka parapa që Kuvendi ta paraqesë përmes një sektori për punë të Kuvendit Komunal në nenin 8, neni i pesëmbëdhjetë i kësaj draft rregullore i pëshkruar, i pëshkruan detyrat e këtij sektori për punën, për punë të Kuvendit parasheh numrin e të punësuarve, tre, dhe përgjegjësitë që ka ndaj drejtorisë së Administratës të nderuar duke e ditë që Kuvendi dhe ekzekutivi janë pushtete të ndara mendoj që ky sektor dhe udhëheqësi i tij do duhet të raportojë Kryesuesit të Kuvendit prandaj propozoj që Kuvendi të ketë rolin e tij të ndarë nga ekzekutivi dhe ky sektor të jetë nga administrata aktuale e jo të hapen vende të reja siç e potencoi edhe Kryesuesi i Kuvendit ne nuk jemi ka kërkojmë që të merren punëtorë të ri mirëpo të sistemohen në zyrën e Kuvendit për çështje të caktuara ne kemi pranuar edhe një propozim ndryshim nga Kryesuesi i Kuvendit, i cili jep sqarimet e nevojshme se si do duket ky organizim i brendshëm apo struktura organizative e komunës unë jap mbështetje këtij propozimi, duke besuar që Kuvendi në punën e tij do të jetë shumë më i përgjegjshëm në shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimeve të Kuvendit ju e dini koleg të nderuar që ne gjatë këtij mandati po edhe unë e kam qënë edhe në mandatin e kaluar ne kemi me dhjetra vendime që na kthehen pas nga Ministria e Pushtetit Lokal për shkak të ligjshmërisë së atyre vendimeve prandaj ne na ka munguar zyrtari ligjor na ka munguar zyrtar financiar ju e dini që në raportet financiare që vinë kemi shpenzime që i dedikohen shpenzime që nuk i ka bërë Kuvendi dhe i dedikohen Kuvendit, si ato të derivative të ushqimit etj, dhe prandaj mendoj që deri tani Zyrja e Kuvendit me përjashtim të këtij mandati që duhet ta falënderoj pak a shumë ose të i jepi pak merita shumë ma të mëdha Kryesuesit të Kuvendit e ka ngjallë me zyrë edhe e ka ngjallë pak Zyrën e Kuvendit si Kuvend si zyrë, si... sepse Kuvendi në periudhën paraprake pothuajse nuk ka ekzistuar fare vetëm që mbledhjet e asamblesë kur janë mbajt edhe kështu se prandaj unë insistoja edhe këmbënguli që nëpërkrahjen e gjithë neve që Zyrja e Kuvendit ta ketë rolin meritues në sistemimin apo kvtë draft rregulloren që është ka përpunohet prandaj edhe njëherë zot i Kryesues ju dhe gjithë juve kolegë, ju kisha ftu që ti japim mbështetje edhe këtij propozimi ju falemnderit!

Hajdar Sutaj

Faleminderit Mon, Vatan Istrefaj është lajmruar për fjalë.

Vatan Istrefaj

Faleminderit kryesues vetëm dua të jemi I qartë nëse ne japim mbështetje kësaj rregullore për te dalë në faza tjera, pra për të shkuar në dëgjim publik, a jepim mbështetje me rekomandimet që ke bo edhe ti apo jashtë tyre? edhe a është e përfshirë Zyrë e Kuvendit si pikë.

Hajdar Sutaj

Realisht ne tash kur e votojmë, e votojmë me rekomandimet edhe kur i nënshtrohet debatit publik i nënshtrohet me rekomandimet që i kemi jepë si me ndryshimet që jepim sot edhe pastaj gjatë fazës që Enver e shpjegoi mundet me pas edhe drejtori e sektorëve ndryshme të cilat ia takon kjo rregullore që mund me japë propozime të ndryshme edhe mas këtij dokumenti na vjen edhe dokumenti përfundimtar me propozime që na e votojmë përfundimisht, a ka dikush tjetër diçka? Orges Tafilaj.

Orges Tafilaj

Falemnderit kryesues fillimisht na u tha që për përpilimin e këtij dokumentacioni, dokumenti rregullor është kontrakti dikush nga jashtë realisht pyetja konkrete është kush saktësisht e ka përpiluar rregulloren sa ka kushtu na tregoj Yllarta edhe pyetja që lind pastaj, pse është dasht me u kontrakti jashtë? A ke mujt me bo përmes një komisioni të asamblesë ose bashkëpunim me ekzekutiv legjislativ? Dhe si rrjedhojë me propozimin që na ka ardhë nga ju rrjedhimisht po i bie që Neni 15 të largohet tërësisht dhe njëkohësisht tek Neni 9, pikë 4.6 të largohet, parimisht jam për që të kaloj në dëgjim publik

Hajdar Sutaj

Më falni Enver Cacaj e ka edhe njëherë fjalën, Enver a dëshiron me shfrytëzuar foltoren Yll e ndez mikrofonin

Enver Cacaj

Atëhere edhe njëher po e marrë fjalën qysh e potencuam në debat publik ose rekomandimet mundemi mi shiku edhe me i inkorporu. Orges sa i përket ekspertit është angazhu ni ekspert sikur në shumë komuna se me pasë angazhu ne një komision kishin punu një person ose dy tjerët nuk kishin punu hiç edhe ish dasht veç mi mar thikat ose kallashat me dalë me u mbyt me puntora din kështu shqip troq po folim gjithashtu edhe një herë po e potencoj, komuna e Gjakovës dhe komuna e Fushë Kosovës nuk jom ka e mohoj për me shtu sektorin të Kuvendi është kon i parapam te faqet rreth te shtojta dy, sektori për punë të ekzekutivit ne administrate edhe unë jam i pajtimit me kalu te sektori i kuvendit vetëm me kalu te sektori i Kuvendit. Komuna e Gjakovës prap po e potencoj Fushë Kosova janë dy komuna më të mëdhaja se komuna e Deçanit jonë të parapame, Komuna e Gjakovës i ka udhëheqjen e sektorit për punë të kuvendit komunalë zyrtarët i lartë për çështjen e kuvendit komunal edhe asistenti i kryesuesit ndersa te komuna e Fushë Kosovës është i njëjti përshkrim i detyrave te punës nuk mundemi me kriju une këtë paralajmrim e kom qe jo për me kriju ose mos me kriju po ne jemi ka dojm me bo sektorin e kuvendit sikur sektorin e parlamentit te Republikës te Kosoves apot po e potencoj me këto pozita qe janë propozu. Unë edhe në KPF kam thënë atë ditë Enveri nuk e ka hartuar rregulloren e ka hartu një ekspert, sa për Enverin e ndryshoni qind për qind rregullorën shtoni ose mungoni është çështje e juaja ju keni me votu dërgohet në interpretim ligjor në Ministri a e vendos ministria a nuk vendos, Enveri nuk e ka personale rregulloren

Hajdar Sutaj

Enver ne të falenderojm shumë rrealisht nuk është rregullorja e pare na kemi pas rregullore që ka sponsorizuar edhe drejtori Izet edhe na kemi kemi shtu diqka ose te Dafina o se ashtu është normale mos ti marrim ashtu... e ka Orgesi Tafilaj fjalën pastaj Albesa Cacaj.

Orges Tafilaj

Ma përmendi emrin në start ka thane Orges, unë e kisha veç një pyetje shkurt, eksperti a ka emër, mbiemër? Edhe a guxoj me ja permend.

Enver Cacaj

E publikum edhe përmes prokurimit është zgjedh eksperti, emrin mbremri është Hajdin Ramadani nuk e di sakt i cilës komun është, kemi bërë takim zyrtar edhe me kryetarin zyrën e kryetarit, dy takime i kemi bo zyrtare, jo ka emër ka.

Hajdar Sutaj

Albesa Cacaj e ka fjalën.

Albesa Cacaj

Mendoj që jam kundër propozimit tënd që thotë ti futim në një paketë edhe draft rregullorën edhe propozimet që kanë ardhë nga ju dhe nga Komiteti për Politikë e Financa në votim mendoj që duhet të votohen ndaras përshmebull draft rregulloria të propozohet edhe të votohet ose të mos votohet pastaj vjen procedura e propozimeve që kanë ardhë nga ju dhe nga KPF-ja mendoj që kjo është ma e drejtë edhe si rregull që ka ndodh falemnderit.

Hajdar Sutaj

Kështu mundesh me pas pak drejt pjesërisht fillimisht votohen rekomandimet nëse votohen rekomandimet atëherë votojmë që me u hekkëto pjesë qe tha Orgesi neni 15 pastaj e pati te neni 9.4.6 edhe votohet me rekomandimet nuk po i qesim pako, po i votojmë rekomandimet pastaj votojmë draftin, Florim Mata e ka fjalën.

Florim Mataj

Na kemi diskutuar pak edhe në Komitet Politik e Financa dashta mu nderlidh me kolegën Enver se atë ditë e ka përdorur të njëjtën fjalë po dukemi si parlamenti I Kosovës atë ditë kërkesa ime ka qenë na nuk po kërkojm të paktën por ndoshta ata zyrtar që janë në komuna të paktën të angazhohen në dy dit apo pesëdit sa ... kështu ka qenë kërkesa ime, dashta me u ndërlidh edhe te një fjalë a ndoshta mos kish me qenë më e rrugës me qen ekspertë sa mundem me pa unë këtu nuk jeni të përfshir asnjë ndoshta është mir me qenë present ekspertë që e ka haruar dhe me na tregu ku kemi të drejtë ligjerisht qfar kemi të drejt me vendos dhe qfar kemi te drejt me largu edhe ajo fjalë besoj kallasha thika nuk po me duket e hijshme me perdor se jemi duke jetuar një shekull tjetër nuk jemi ne atë gjendje besoj as institucionet as diçka tjetër kështu qe kerse ime ishte nese ka mundesi le te vjen ekspertë te na shpjegoj cilat jan te drejt se me sapo shoh nuk është I përfshir as një zyrtar as një drejtor as kerkush I komunes dhe është draft dhe mundemi me ndrru gjat rruges mundemi mi dhan harmonizime propozime dhe ne fazën tjetër ne e vendosim a e kalojm apo nuk e kalojm

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë po patjetër se ju ka përmend emri Enver Cacak pastaj drejtori Izet Zenuni

Enver Cacak

I nderuari Florim qysh e keni potencuar ne KPF me datën 30 maj zyrtarisht kemi shkruar te gjithë drejtorëve imell zyrtare kemi kërku për rekomandime ose ndryshime I vetmi rekomandim ka qenë prej Drejtorisë Mbrotjtjes dhe Shërbimeve Publike një pikë që është kërku nga drejtori Izet që ka mbet pasi te perfundoj debati public a mu inkorporu në rregullore a mos mu inkorporu domethënë asnjë drejtor nuk e ka bo një rekomandim ose një sygjërim ose një vërejtje ku u kon prej dates 30 maj deri me datën 4 qershor janë kon pesë ditë në dispozicion kanë pas me shiku çdo drejtor sektorët detyrat dhe përgjegjësit ku asnjë koment nuk u kanë. Vetëm nga drejtori Izet u kon një koment që ka mbetë a mu inkorporuar në rregullore a mos mu inkorporu drejtori Izet ka kërku monitorimin e ndërmarrjeve lokale dhe regionale mu shtu edhe me u dhënë si përgjegjësi ka mbet mu diskutu, me u shiku a kemi të drejtë apo nuk kemi të drejtë komuna e Deqanit drejtorja gjegjëse mundet me bo monitorimin e ndërmarrjeve lokale dhe regionale nuk kemi pas asnjë koment nga asnjë drejtori.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë Enver për hirë të korrektësis unë edhe atë ditë e kom shpjeguar që me të vërtetë ju keni drejtuar të gjithë drejtorëve por Kuvendit s'ju ka drejtuar kërku dhe na kur e kemi marrë veshë, domethënë që ka qenë kërkesa me hy në rend dite e kemi shiku rregullorën atëherë kemi reagu me komentët tona domethënë nuk jemi përfshirë në atë diskutim, sepse përndryshe ish dashtë që edhe Kuvendi, meqenëse... ne e votojm edhe ka të bëjë me organizimin e komunës e të kuvendit jane dy institucione që e dini mas mirë se sa edhe na, që komuna e ka Kuvendin edhe ka kryetarin i ka dy 01 edhe 02 me qenëse na po kërkojmë diçka veç te përfshirja e 01 në këtë rregullore drejtori Izet Zenuni e ka fjalën.

Izet Zenuni

Qdo rregullore në draft të parë në lexim të parë vjen me të meta me gabime po kryesore vjen në Asamble diskutohet I nënshtrohet diskutimit public në fund e merr epilogun edhe merr formën e prerë unë mendoj që nuk e kisha sugjeruar që me e votu me rekomandime, se në qoftë se votohet me rekomandime vetëm te një sektori këtë rast Kuvendit edhe rekomandimet e drejtorëve tjera në të ardhmën përshembull që kan me ardhë, mendoj si paket si draft rregullore kështu siq është ta votojm të kalojm në diskutim publik atëher gjatë rrugës I japim rekomandimet mbledhjen e ardhëshme mundemi me.. po po.

Hajdar Sutaj

Drejtor të falënderoj për sqarimet unë mendoj që kur do që keni rekomandime, ata që i kanë sjell rekomandimet, ti pas ke qu, i pas kanë shti ne i kemi sjell sot, ti pas ke qu rekomandimet, i pas kan shti ne ven nuk na kanë pru atëherë me na jep afati me shti rekomandimet na i kemi sjell në KPF i kemi votu, i kemi qit edhe sot nëse anëtar... na kërkojmë që mu votu rekomandimet, me i përcjell për në rregullorë pastaj sjellni edhe rekomandimet tjera i shfaqtojmë e votojmë ose jo. Halil Tolaj e ka kërku fjalën pastaj Vatani, pastaj Miftari.

Halil Tolaj

Përsëritet për të gjithë. Kjo rregullore relativisht është e mirë për organizimin e brendshëm të organizatës komunale po nuk mund të quhet rregullore për sistematizimin e vendeve punës përveç ketyrë që janë në aneks, kryesuesi i kuvendit i ka bo do. Sistematizimi i vendeve të punës është krejt tjetër në këtë formë çfare mendohet le ta merr formën definitive le të aprovohet nga Asambleja kjo nuk mund të funksionon nuk mund të funksionon nëse themi filon drejtorati i ka tridhjetë punëtorë dhe nuk dihet kush qfar ka me bë duhet titujt e punës, duhet përshkrimi i vendit të punës duhet kualifikimi për sistematizimin vendeve të punës. Përshkrimi është i bërë në vetën për organizimin administrat nuk është ky sistematizim që kanë me u paraqit problemet. Thuhet për shembull drejtorati për inspeksion i ka shtat punëtorë, dhe nuk dihet tash cili inspektor duhet taksativisht detyra se nese duhet mu ballafaqu me ligjin dhe ja kërkojn shefit të... personelit ja kërkon për shembull gjyqësori detyruar te Halilit ato përshkruhen si sistematizim vendeve të punës dhe mendoj se ky ekspert kush do të ketë qen ai, për organizim mbrendshëm ndoshta është shkruar si me të gjitha komunat ka bo ni punë. Nuk mund të ja mohojmë po nuk është sistematizim i vendeve të punës mos të mashtrohem se ka me qenë l pa zbatueshëm këtë vërtetë e pata.

Hajdar Sutaj

Enveri e ka fjalën për një argument pastaj Vatani dhe Miftari

Enver Cacaj

I nderuar drejtor Halil koleg i nderuar rregulloja nuk çitet ne aprovim ose miratim te përshkrimi i vendit të punës nuk çitet në Kuvend. Është përshkrimi i detyrave të punës për të gjitha pozitat e punës, po nuk çitet për aprovim në Kuvend. Rregulloja çitet strukturat organizative, detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorive dhe sektorëve, ndërsa detyrat dhe përgjegjësitë e çdo pozite të punës janë të hartume, ku masi të aprovohet rregulloja, çdo zyrtar e nënshkruan dhe pajtohet me ato detyrat te punës, sikurse janë konkurset publike ku përcaktohet çdo pozitë e punës me konkurs publik, automatikisht i shkon edhe detyra dhe përgjegjësitë, ndërsa përshkrimi i vendeve të punës nuk kalon përmes Kuvendit për aprovim ose miratim. Janë gjitha pozitat, janë gjitha pozitat e aprovime sipas rregullorës për sistematizimin e vendeve punës 16.2024 e nivelit qendror e specifikon çdo fazë, çdo detaj të rregullores dhe përshkrimit të vendit të punës nuk çitet përshkrimi i vendit punës në kuvend për miratim.

Hajdar Sutaj

Faleminderit Enver me thënë të drejtën na nuk është që e kemi ndonë njohuri decideve për këtëpunë ndoshta sigurisht në fazat ne vazhdim mundem me pas informata shtes, Miftar Ahmetxhekaj e ka fjalën.

Miftar Ahmetxhekaj

Faleminderit shumë kyresues, së pari sa i përket dokumentit duhet te aprovohet kështu apo me rekomandime. Po flas për vete, unë e kom pranë ni dokument, po supozoj brenda afatit ligjor para një javë dite edhe unë e lexoj dhe trajtoj dokumentin të cilën e kom përpara. Rekomandimet që jepen grupit të caktuar të interesit, në këtë rast KPF-ja mbesin si rekomandime që duhet ti pranojë në këtë rast zyrtari përgjegjës, siç është Enveri dhe pastaj këta nëse e vlerësojnë në diskutimet publike i harmonizojnë ose jo.

Unë, Enver veq te them te sektori për punët e Kuvendit realisht i keni parapa tri vende pune në kuptimin ligjor qka paraqet problem unë këta spe kuptoj. Nëse eventualisht na po flasim për zyrtar, të cilët i nënshtrohet ligjit për zyrtar publik. Ku është problemi nëse shtrohen edhe dy? Temë tjetër është, kjo çka e kërkoj kryesuesi nishi dyshi që edhe unë e mbështet që duhet të jetë. Realisht edhe unë e kom po më qenë se është në lexim të parë do t'i boj propozimet, se edhe tek emërtimet sektor njësi zakonisht tanë nëpër ministri të caktume, zyrat që kryjnë shërbime me ni ose dy tre zyrtarë, me rregull quhen zyrë. Zyra e Prokurimit, Zyra e Auditimit, Zyra për Çështje Ligjore edhe në ligjin e pagav dot organigrami rënditen ma lehtë. Sigurisht, unë përshembull një prej ideve që kom që mendoj Deçanit dhe komunat tjera veq e kanë është drejtoria për çështje përmbyllje përkatase dhe çështjet për njësi juridike. Unë mendoj që duhet të jenë dy drejtori të veqanta. Deçani ka shumë probleme për çështje pronësore juridike ndoshta e kish rregullu e kish rregulluar si çështje. Megjithatë meqenëse është në lexim të parë unë do të mundohem që ne të ardhmen të japë kontributin tim në kuptimin profesional, falemnderit shumë.

Hajdar Sutaj

Faleminderit Miftar, Vatani pastaj nëse ka diqka me shtu Enveri

Vatan Istrefaj

Faleminderit kryesues, po mundohem të jem i shkurtë pra ne në parim jemi pro kësaj draft rregullore për shkak se është shumë e nevojshme, organizimi brenda dhe sistematizimi i vendeve të punës në administratë por edhe me rekomandimet tua kryesues, është mirë që ne ta shohim një bazë ligjore se a kemi drejtë të rekomandimit ti votojmë kësaj radhe apo të lëmë këtë pas dëgjimit publik rekomandimet mundën me ardhë unë edhe ti qdo asamblistë tjetër këtu me i bë rekomandimet në dëgjim publik edhe mi futë në rregullore po nëse këta se shohin të arsyeshme, as ne nuk e shohim të arsyeshme me votu tani kështu që kemi hapësirë sa të duash edhe 2 a 3 muaj

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë Vatan, realisht po veq po du me ju thënë shikoni ne rregulloret që i ka hartuar eksperti te neni 6 nuk po e di cilen faqe me gjasë duhet me kan faqja e tret se numri nuk po shkruan, te struktura organizative administrates komunale neni 1.1 kabineti I kryetarit 1.2 drejtoret 1.3 sektorët hyni shikoni kudo një komunë nëse nuk është 1.1 kuvendi unë nuk e votoj dotëthotë e largojm kuvendin total, 1.1 fillon kuvendi është organi më lart në komunë edhe kjo nëse neve nuk na ka ardhur me kohë ka ndodhur gabim nuk na ka ardhur nuk jemi perfshir ne diskutim le të hyj tashti kjo kur të del në dëgjim publik duhet të hyj me kuvend, pastaj a duhet me qenë apo nuk duhet a largohet gjat rruges a behet diqka ne rregull le ti nënshtrohet debatit me të tjerët, Enver a kishe diqka me shtu

Enver Cacaj

Ta kalojmë në lexim të parë e mbajmë debatin public, por e ftoj edhe ekspertin mundet ndoshta me na jep edhe më në detaje arsyet ose rekomandimet a bënë, ose nuk bënë, pse bon ose pse nuk bënë, për një qështje të caktuar.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë, megjithatë unë e falënderoj dhe e përgëzoj edhe ekspertin që ka bë..Unë e qes fillimisht rekomandimin, po Florim, Florim Mataj e ka fjalën dhe flisni për shkak të procesit.

Florim Mataj

Qysh në draft kur flasim këtu bëhet fjalë nuk po e lexoj komplet po thotë në administratën komunale domethanë qysh në titull nuk ka të bëjë me kuvendin dhe me ne është një rregullore që bëhet për punëtorët e administrates komunale tash kjo rregullore ose duhet me u bë për puntort e administrates komunale dhe stafin (...) ama në start nuk jemi pjesë e kësaj.

Hajdar Sutaj

Më falni shumë, e vërtetë kjo që tha Florimi, nëse e keni vëmendjen të gjithë, thotë që struktura organizative e administratës komunale. Propozimi jonë është sikurse e kanë të gjitha thotë struktura organizative e komunës së Deçanit, thotë e komunës së Deçanit, domethënë në propozimin është propozoj dy pika, dy pika struktura organizative e komunës së Deçanit edhe vazhdoet struktura organizative e komunës së Deçanit si vjon 1.1 Kuvendi i Komunës, 1.2 Kryetari i Komunës, 1.3 Drejtorët 1.4, Njësit sektorët edhe vazhdoet 1.7 atë që e tha Orgesi Neni 15 largohet edhe të 1.7 është Kuvendi i Komunës prej ku përbëhet Kuvendi i Komunës, detyrat edhe përgjegjësitë e Kuvendit të komunës dhe pastaj vazhdon me piken tjetër që është kryetari edhe organizimi i administratës komunale. Unë e kisha qit në votim rekomandimet që i kemi dhënë ne, votoni pro kundër si ta vlerësoni ju edhe unë kisha kërku që nëse Kuvendi nuk voton për vete nuk kemi qfar të themi, në rregull është unë e qes në votim kush është për rekomandimet. 17

Kush është kundër?

Kush abstenon? 17 për dhe 1 abstenim.

Tani e kemi rekomandimin që drejtorë se jemi në proces të votimit, e kemi rekomandimin për nenin 22, më falë 1 minut e kemi rekomandimin për nenin 22, Përfshirjen e drejtorit te Qendrës për Puna Sociale kush është për që me mbet struktur organizative? Është fjala për hy në draft më falë 1 minut jemi në proces.

Kush është për? Me ngjitje dore mundësisht, 12.

Kush është kundër?

Kush abstenon? 12 për, 7 kundër, Abstenim.

Tani e qes në votim si draft komplet, kush është për? Me rekomandimet tani e kam qitë në votim kush është për drejtorin e Ministrisë? Me rekomandime 16 vota.

Kush është kundër?

Kush abstenon? Kuvendi Komunal e ka votuar me dy rekomandime draft Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës, nuk ka dert le ta kthen, e kemi votu draft rregulloren.

Urdhëro drejtori I shërbimeve Publike Izet Zenuni e ka fjalën, a pate diçka me thënë

Izet Zenuni

Jo, se me këto rekomandime qe keni votu këta, që atje ka pasur problem. E ki mundësinë i vërejnë komplet edhe ty. Dhe përfundimisht, si prej kohësh.

Hajdar Sutaj

Mfalni, dokumentin final e votojmë pa to, a po kupton. Po jo se si votojmë kundër, mos u tut. Jemi te pika shtatë, gjegjësisht e gjashta kërkesa për banorët e fshatit Bella e Epërme për përkrahjen financiare për hapjen e rrugës së re fshatin Bella e Epërme. Drejtoreshë a ke diçka me thene lidhur me kete? Arian?

Arjan Dobraj

Krësus falënderit. Meqense kërkesat e tilla te kësaj natyre, sidomos në shumën që është kërkuar, na vijnë pak ma rrallë te themi kështu. Ne si grup faktikisht nuk po e kundërshtojmë, nuk po e kundërshtojmë asesi kërkesën e fshatit Belle, megjithese qenkan vetëm pese nënshkrimet të së njëjtit mbiemër. Realisht ne kishim sygjjeru edhe drejtorise financave dhe drejtorise për shërbime publike, meqënëse dul, që me vepru sipas kontratave ose sipas marrëveshjeve kontraktuale që i keni me, me kompanit ose s'po di sipas projektit, sepse nuk po me duket e arsyeshme për momentin. Kështu që kisha sugjeruar për me e shty për një seancë tjetër, nëse është e mundur.

Hajdar Sutaj

Realisht, me sa kuptova, ti rekomandove që kjo punë mu kry prej kompanive që janë të kontraktume. Ne rregull, ne emër te LDK-se Miftar Ahmetxhekaj.

Miftar Ahmetxhekaj

Faleminderit shumë kryesues. Në parim kërkesat e tilla të cilat e rregullojnë jetën, infrastrukturën e qytetarit, gjithsesi i mbështesim. Unë e kam kështu drejtorin. Sa e di fshati Belle është njësi administrative e komunës së Deçanit. Është fshat sikur krejt fshatrat e komunës së Deçanit. Ju paraprakisht e keni nënshkru një kontratë për rregullimin e rrugicave të komunës së Deçanit. Pse duhet me nda, pse duhet të trajtohet një kërkesë kështu, qka bojnë ata me 20,000 euro, pse nuk, thjesht në harmoni me parafolesin te angazhohet kompania ne fjalë i cili ka per detyrim me i kry këto punë edhe ta kryej edhe atë punë e qka duhet. Unë sbesoj që është e mjaftueshme kjo shumë, veq nese është rrugë, rrugë, livadhe, rrugë maleve, se nuk di çka bojnë këta me njëzetmijë, në parim e mbështesim, po kjo sju kryne punë osht mirë me kompani të angazhohen edhe tu bohet zgjidhje ashtu qysh duhet. Faleminderit shumë.

Hajdar Sutaj

Faleminderit. Vetevendosja? Orgesi.

Orges Tafilaj

Faleminderit kryesues. Në parim edhe ne e mbështim sidomos per gjallerimin e fshatit Belle dhe njëkohesisht mungesen e informacionit e kemi kogja shumë, për shkak se nese personat që e kanë nënshkru janë të një familje, të një lagje dhe të njëjtit nuk kanë qasje në infrastrukturë si familjet tjera, atëherë, për shkak të barazisë në shërbime dhe qasjen në infrastrukturë, personalisht e kisha perkrah, nëse është ky rasti. Faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë. Mon Selmanaj.

Mon Selmanaj

Edhe unë në parim e mbështes, zoti kryesues. Po. Po. Po, sigurisht.

Hajdar Sutaj

Dafina Cacaj e ka fjalën.

Dafina Cacaj

Na nuk mundem me ja ndalu ose me i tregu dikujtë... na mundohemi ndoshta me e bind që na mundemi me e kry me kontratat tana, mirepo nuk mundem me ja imponu që mos me bo kërkesë që me ju drejtu juve për këtë ndihmë financiare që ata e kanë kërku. Ata jane drejtu drejt juve për këtë arsyeje edhe, a janë familjarë a sjan une këtë nuk e di se si njoh asnjonin, mirëpo, qyshdo që ju e vendosni për mu është ne rregull.

Leotrim Hadergjonaj

Po, përshëndetje, atëhere unë kisha sugjeru pak më mirë me shku përderisa na patjetër duhet me përkrah një kërkesë të tillë, sepse janë tu shtru rrugë, livadheve, bahqeve, arave edhe gjithkrah, ska gjë të keqen nëse shtrohet sidomos në një zonë ku është shumë problem e qarkullushme pa asfalt. Përderisa kemi ni kontratë publik me ni operator ekonomik mbi shtatë milion euro, pse ata mi pagu dhjetë mijë euro prej xhepit te vetë e dhjetë mijë komuna, përderisa në qdo fshat tjetër nuk është tu pagu më kurkush, i ka dhjetë vite që spagun bashkëfinancim për një rrugë publike. Është mirë këte me votu po na me shti drejtorin e kemi te sherbimeve publike, ky mundet nashta me analizu me menaxher te kontratës me hi në kuadër të projektit egzistues me punë shtesë dhjetë përqind që i kryejnë shtatqind mijë euro, jo vetëm dhjetë mijë euro, ata mos me pagu fare, por brenda kontratës me ja u kry si qdo lokalitet tjetër.

Faton Selmanaj

Sa është për hapjen e një rruge te re, a ish dashtë na paraprakisht me marë edhe ni vendim që me ja leju hapjen e asaj rruge si kuvend.

Miftar Ahmetxhekaj

Po nëse bën kryesues, drejtor, kryesues meqenëse kuvendi ju ka drejtuar ni kërkesë prej familjeve të caktuar anëtarët të familjes për një kërkesë se si këta e trajtojnë pasi që të merr vendim është qështja e tyre. Kuvendi duhet të jep mbështetje kërkesës se tillë, ne dojmë pastaj drejtorja e Financave a ja merr 10 mijë ose nuk ja merr është qeshtje e tyre unë kërkoj që ju kërkesën e palës me qit ne votim. Kryesues modalitetin e gjejnë këta po mendoj që edhe profesionalisht edhe kërkesa edhe në raport me palët, që ne mos të jemi në hak, unë kërkoj, kryesues kuvendi, na e qesim propozimin kryesues këta le ta gjejnë modalitetin, unë kërkoj që me qit propozimin në votim.

Hajdar Sutaj

E qes në votim kërkesën, kush është për, kush është kundër kush abstenon, atëherë me 7 vota për ndërsa anëtarët tjerë të kuvendit nuk marrin pjesë fare në votim konstatoj se kjo kërkesë nuk kalon.

Pika 8. Marrëveshja në mes së komunës së Deçanit edhe KRU Drini i Bardhë për hapjen e kanaleve të ujititjes, për fermerët e komunës së Deçanit.

Anëtarët e kuvendit e miratojnë këtë Marrëveshje njëzëri, në momentin e votimit në sallë janë 18 asamblist, shuma e miratuar është 11,500.00 euro.

Hajdar Sutaj

Mirupafshim ne takimin e radhes.